

Konferencë
Koha për ta kapur trenin për në BE

Fq.3



RASTI MONSTRA
Dëshmitar i fshehtë ndryshon rrëfimin

Fq.5



Tryeza politike shqiptare
Forum

Fq.11



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3449 · e shtunë/e diel, 1-2 shtator 2018

18°C | 29°C

15 DEN

FORUM

Të (mos) jesh
Zijadin Sela



Referendumi për emrin e ri Republika e Maqedonisë Veriore do të mbahet në ditën e fundit të shtatorit, partitë që e përkrahin marrëveshjen (kryesisht në pushtet) u takuan më 29 gusht, në të cilën nuk desh të marrë pjesë Zijadin Sela, por Zijadin Sela dhe partia e tij, tri ditë më parë u prononcuan Pro, pavarësisht se në hartimin e Marrëveshjes me Greqinë kjo parti nuk ka marrë pjesë, e si opozitë shumëkush do të prishte prej saj të jetë Kundër. Por, ndoshta ky është thelbi i dallimit të një partie kryesore opozitare shqiptare nga një parti kryesore maqedonase (VMRO-DPMNE). Dallimi, pra, qëndron në qëndrimin ndaj interesave strategjike të vendit, ku të qenit opozitë nuk do të thotë të...

Fq.10

RAJON

Thaçi nuk heq dorë nga korigjimi i kufirit

Fq.16

GLOBI

Ushtria e padukshme e Putinit

Fq.17



MBI 23 MILIONË RECETA PËR NJË VIT

GJYSMA ME "DIAZEPAM"



"Pothuajse për çdo vit po shndërrohem në popullatë tepër të stresuar, po bëjmë një jetë shumë dinamike, nuk përdorim ushqime të shëndetshme apo kemi probleme me kilogramët e tepërt. Të gjitha këto fenomene kanë të bëjnë me faktin se qytetarët realizojnë më shumë receta që kanë të bëjnë me sëmundjet kardiovaskulare. Gjithashtu kemi dhe rritjen e numrit të rinjve që kanë probleme me stresin e që çon nga viti në vit në rritjen e të rinjve që konsumojnë 'Diazepam'", thonë nga FSHM-ja

Fq.4

Dhunuesit na donin të vdekur

Shkup, 31 gusht - Të gjithë 33 të akuzuarit përngjarjet më 27 prill në Parlamentin e Maqedonisë ishin të pranishëm në seancën e djeshme gjyqësore në Gjykatën Penale në Shkup, në të cilën dëshmuar katër dëshmitarë të Prokurorisë, konkretisht ministri Damjan Mançevski dhe deputetët Frosina Remenski, Pavle Bogoevski dhe Ilija Nikollovski. Para Trupit gjykues, Mançevski tha se më 27 prill ka qenë në pres

sallën e Parlamentit së bashku me Zoran Zaevin dhe deputetët e tjerë dhe se kur turma ka hyrë në pres qendër, ka vërejtur një njeri me bluzë të zeze dhe shenjë të "HOS" (Forcave të Armatosura Kroate), i cili ka mbajtur armë.

"Turma e hapi derën. Një grup i madh i njerëzve u nis drejt nesh dhe filloi të godasë me duar, karrige, tastatura, stativat e kamera



EDITORIAL

KOHEZIONI
RAJONAL

Emin AZEMI

Ballkani Perëndimor ka një treg shumë të pa harmonizuar mes veti dhe del që marrëdhëniet ekonomike e tregtare të kalojnë nëpër vështirësi të shumta. Edhe përkundër marrëveshjeve reciproke që obligojnë shtetet nënshkruese t'iu përmbahen rregullave të caktuara, nuk janë të rralla rastet kur prodhuesit dhe subjektet e ndryshme afariste sillen në mënyrë arbitrare.

Ajo që bie në sy është sidomos raporti shpërpjestues në import dhe eksport dhe për pasojë ndodhë që shkëmbimi tregtar të jetë i njëanshëm, gjegjësisht mallrat e njërit shtet të dominojnë në tregun e shtetit tjetër, duke krijuar në këtë mënyrë disbalance të panevojshme tregtare ekonomike. Ja disa fakte që e ilustrjnë këtë situatë.

Maqedonia vitin e kaluar ka prodhuar 705 mijë hektolitra birra. Prej kësaj sasive, shumica e birrës eksportohen në Kosovë. Kështu thuhet në statistikën e fundit të Entit Shtetëror të Statistikave, sipas të cilës, vitin e kaluar, nga Maqedonia u eksportuan 8 milionë e 61 mijë kg birra dhe u importuan shtatë milionë dhe 307 mijë kg birra. Shumica e birrës vitin e kaluar u eksportuan në Kosovë, respektivisht 3 milionë e 292 mijë kilogram birra në shishe dhe 1 milion e 223 mijë kilogram birra në paketim deri në 10 litra.

Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, ka thënë se bizneset e Kosovës po ndeshen me sfida të ndryshme në eksportin e produkteve të tyre në Maqedoni. Bilanci tregtar i Kosovës është negativ dhe shumë i madh. Kosova tani prodhon produkte shumë cilësore dhe mund të eksportojë shumë produkte. Kosova tani më lehtë eksporton në vendet e BE-së sesa në Maqedoni, ku ka barriera të ndryshme, jo të arsyeshme. Këto barriera duhet të hiqen", tha ai ditë më parë në emisionin e mëngjesit "Mirëmëngjesi Kosovë", në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).

Sipas marrëveshjes së CEFTA-s, ku Kosova dhe Shqipëria janë anëtare dhe nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, e cila i bënë pjesë të një tregu të përbashkët, përveç tjerash vendet nënshkruese nuk do të duhej të përdornin barrierat jo-tarifore për të bllokuar qarkullimin e lirë të mallrave dhe njerëzve. Mirëpo sa i përket Maqedonisë, siç pretendon edhe Oda e Afarizmit e Kosovës, ajo përherë ka aplikuar forma të ndryshme të barrierave jo-tarifore për të penguar çdo tentim eksporti të mallrave nga Kosova për në Maqedoni, në rastin konkret bëhet fjalë për pengesën që i bënë prodhimeve me prejardhje shtazore duke mos e dërguar inspektoratin ose duke mos i licencuar kompanitë kosovare të eksportojnë në Maqedoni, derisa në anën e kundërt ka me dhjetëra kompani maqedonase të licencuara për eksport të po këtyre prodhimeve për në Kosovë.

Në funksion të ruajtjes së ekonomisë vendore nga invazioni i jashtëm, Kosova më 18 korrik, për të mbrojtur prodhimet bujqësore të vendit, vendosi të rrisë taksën doganore për 30 për qind për produktet bujqësore që futen në tregun e Kosovës, nga të gjitha vendet e rajonit. Si më e goditura nga ky vendim llogaritej Maqedonia, si shtet prej ku është furnizuar një pjesë e madhe e tregut të Kosovës me pemë dhe perime.

Por, njohësit e çështjeve ekonomike thonë se përplasjet mes Shkupit dhe Prishtinës rreth mbrojtjes së prodhimeve bujqësore, nuk po shfaqen për herë të parë dhe këto përplasje duhet parë si fotografi më e gjerë, kur edhe Shkupi në vitin 2013 morri vendim që të mbrojë një pjesë të prodhimeve të tij, siç ishte mielli dhe produktet e qumështit. Bllokadat nuk janë zgjidhje. Maqedonia dhe Kosova duhet ti shqyrtojnë prioritett dhe nevojat e konsumatorëve të tyre dhe mbi këtë bazë duhet të zhvillojnë edhe politikat tregtare në mes veti. Gjithçka që del jashtë këtyre parimeve e prishë kohezionin rajonal të bashkëpunimit tregtar e ekonomik dhe krijon parakushte për dominim të një vendi mbi tjetrin.

ENTUZIASTËVE TË PLANIT TË THAÇIT

"Të gjithë entuziastëve të 'Planit' të Thaçit iu garantoj një gjë: Hashim Thaçi nuk ka plan, ashtu sikur nuk ka pasur kurrë një plan për asnjë gjë. Prandaj, kontrolloni entuziazmin tuaj, lerini përrallat për kohën e ndryshimeve, mos llomotisni pa ditur gjë nga politika, nga librat e as nga jeta! Një plan që nuk ekziston s'ka se si të kalojë.

Nëse flasim për Serbinë, po ajo ka një plan që nga humbja e luftës në Kosovë. Ky plan është ndarja e Kosovës që ajo e ka humbur me luftë! Doni ta përgjysmojmë tokën tonë e t'ia japim gjysmën Serbisë së Vuçiqit e gjysmën tjetër Shqipërisë se Edi Ramës, apo e doni Kosovën e plotë dhe sovranë që ruan të drejtën e bashkimit me Shqipërinë?

Unë e dua këtë të dytën dhe ftoj të gjithë shqiptarët që të mos duan një Kosovë tjetër pos kësaj që e kemi fituar me gjak! Hashim Thaçi t'i ndal menjëherë aventurat e tij dhe ju spiujt e tij ndaleni luftën psikologjike që po e bëni se nuk ua ka kush tutën! Kosova do të mbetet kjo që është, sovranë dhe nuk do t'i falet askujt, as vetë Shqipërisë! Ndalni këto aventura se nuk do t'ju durojmë! Ndalni menjëherë!", shkruan në profilin e tij në Facebook, shkrimtari Liri Loshi.

NDRYSHIM I PAKOORDINUAR

"Presidenti i Serbisë mund të jetë i kënaqur me pozicionin të cilin po e mbërrin në botë. Brenda një jave këshilltari amerikan i sigurisë kombëtare, John Bolton, tha se SHBA-ja nuk do të përzihet nëse "dy qeveritë" (Kosova dhe Serbia) arrijnë në heshtje marrëveshje për korrigjimin e kufijve, komisar i evropian Hahn inkurajoi më tutje këto marrëveshje sekrete, duke nënvizuar se ato nuk do të vlejnjë për pjesët e tjera (Bosnjë, Maqedoni), ndërsa kancelarja Merkel, pas bisedës me presidentin amerikan Trump, u deklarua se "ne natyrisht i mbështesim të gjitha bisedat që mund të çojnë drejt qëllimit, por, në të njëjtën kohë, themi se integriteti territorial ashtu siç është tani është një vlerë e rëndësishme".

Ka të përbashkëta në këto tri deklarata dhe gjëja e parë është se bëhet fjalë për një ndryshim në politikën e jashtme, dhe një ndryshim i cili është i pakoordinuar. Deklarata e Boltonit dhe reagimi i kancelares Merkel rreth kufijve tregojnë hapësirë fërkimi mes një politike të jashtme amerikane që ende po i përshtatet presidentit Trump dhe traditës evropiane të ndërtaur nga zhbërja e Jugosllavisë. Por, për këtë, ndonjëherë tjetër, në një shkrim më merit. Kësaj here do vlerësojmë të përbashkëtat nga aspekti i tri pikëve të mëdha të fituara për politikën e jashtme serbe. Pika e parë është se po legjitimohet një proces, i cili në formë sekrete po zhvillohet tashmë një vit. Për Serbinë kjo është shumë me rëndësi, sepse ekziston obligimi i saj për të mbërritur një marrëveshje 'ligjshëmrisht të obligueshme' me Kosovën, në mënyrë që të kalojë fazën përfundimtare të anëtarësimit në BE...", shkruan në profilin e tij në FB, publicisti Veton Surroi

MEDIACitate

SERBËT SIPAS
MODELIT TË TIROLIT
JUGOR, POR NË
KOSOVËN E PAVARUR

Përfaqësuesit e pushtetit në Prishtinë po ua prezantojnë me të madhe ambasadave perëndimore zgjidhjen e tyre për statusin e Kosovës së pavarur, sipas të cilës pozita e serbëve do të rregullohej sipas modelit të Tirolit Jugor në Itali. Siç shkruan e përditshmja e Beogradit - "Novosti", kur Beogradi kishte hyrë në negociatën me Prishtinën, modeli i Tirolit Jugor ishte përmendur si opsion, por për gjithë territorin e Kosovës në raport me Serbinë qendrore. Tani, shton kjo gazetë, modeli i Tirolit Jugor është i mirëseardhur për shqiptarët, si një alternativë për Bashkësinë (Asociacionin) e Komunave Serbe, por me kusht të rrumbullakimit të sovranitetit në gjithë territorin dhe që kështu krijojnë kushtet të konkurrojnë për karrigen në Kombet e Bashkuara. "Novosti" rikujton se Tirolit Jugor është një territor autonom në Italinë Veriore, e vendosur në zemër të Alpeve dhe përbëhet nga dy krahina - Terentina, ku flitet gjuha italiane, dhe Bolcana ku jeton pakica kombëtare gjermane. Në bazë të Marrëveshjes së Paqes, me të cilën u përfundua Lufta e Parë Botërore, Tirolit Jugor i mbeti Italisë dhe që atëherë nisi kontesti me dekada ndërmjet Vjenës dhe Romës deri sa nuk u arrit marrëveshja për autonomi, më 1971.

(Novosti, 31 gusht)

"SERBIA S'PRANON
ZGJIDHJE
POSHTËRUESE
ME KOSOVËN"

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka pritur sot ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Beograd, Denis Keefe, me të cilin, pos për çështje bilaterale, raportohet se ka biseduar edhe në lidhje me dialogun Prishtinë-Beograd. "Të dy bashkëbiseduesit, në lidhje me situatën në rajon, kanë diskutuar edhe për çështjen e dialogut ndërmjet Beogradit e Prishtinës. Presidenti Vuçiq ka theksuar nevojën e arritjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme e të drejtë me Kosovën, por e cila nuk do të ishte në kundërshtim me interesat shtetërore e kombëtare të Serbisë", citojnë mediat atë. "Serbia kurrë nuk do të pranojë një zgjidhje, e cila do të ishte poshtëruese për shtetin tonë dhe popullin tonë", është shprehur ai, raportojnë mediat.

(Koha Ditore, 31 gusht)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUSH ISHTEGOTFRID LAJBNIC?

Gotfrid Lajbnic (1646-1716) ishte filozof e shkencëtar gjerman. Shfaqti interes edhe për gjuhën shqipe. Në pesë letra shkruar nga 24.06.1704 deri më 15.03.1715 mikut të tij M. V. La Krozë kryebibliotekar në Berlin, shtroi problemet e prejardhjes së gjuhës shqipe, të përkimeve, takimeve dhe marrëdhënieve të saj me gjuhë të tjera indoevropiane, dhe të nevojës së dallimit të asaj që shqipja e ka të vetën nga

ajo që e ka huazim. Vuri në dukje përkime e analogji të fjalëve shqipe me fjalë të gjuhëve gjermanike, latine etj. Tërhoqi vëmendjen te mëvetësia individualiteti i gjuhës shqipe si gjuhë e veçantë, e dallueshme nga sllavishtja, hungarishtja, greqishtja, turqishtja. U interesua për të pasur Fjalorin latinisht-shqip të F. Bardhit dhe një vepër të P. Budit që kishte arritur ta shtinte në dorë La Krozi.

"Me marrëveshjen me Bullgarinë, dhe tani me marrëveshjen me Greqinë dërgojmë porosi serioze se fryma evropiane dhe vlerat qëndrojnë edhe këtu në Ballkanin Perëndimor, që të dërgojmë porosi të shpresës për perspektiva të mira", tha Zaev

Koha

Evis HALILI

Shkup, 31 gusht - Maqedonia vitin e fundit ka bërë shumë hapa përpara. Forcat përparuese zgjidhën çështje të rënda si kontesti me emrin, me qëllim që vendit t'i sigurohet prosperitet. Përfitimet nga anëtarësimi në BE dhe NATO janë të mëdha edhe për shtetin edhe për qytetarët dhe për atë duhet të shfrytëzohet momenti. Këto janë një pjesë e qëndrimeve të pjesëmarrësve në Konferencën e djeshme ndërkombëtare "Maqedonia sheh përpara: është momenti për ta kapur trenin për në BE", në të cilën i pranishëm ishte edhe kryeministri Zoran Zaev. Ai theksoi se është shumë mirë që për Maqedoninë si një vend shumë i vogël mund të flitet për përparim të tillë. Kemi tha, shumë për të mësuar, por edhe të japim shumë për Evropën.

"Me marrëveshjen me Bullgarinë, dhe tani me marrëveshjen me Greqinë dërgojmë porosi serioze se fryma evropiane dhe vlerat qëndrojnë edhe këtu në Ballkanin Perëndimor, që të dërgojmë porosi të shpresës për perspektiva të mira", tha Zaev. Ai potencoi se para Maqedonisë dhe qytetarëve është periudha kur duhet të sillen vendime serioze, të cilat, tha, nuk janë të lehta, por, megjithatë, potencoi, i garantojnë të ardhme serioze Maqedonisë dhe rajonit. "Në rrethana të tilla mund të them se kur përmes një marrëveshje merrni për obli-

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE "MAQEDONIA SHEH PËRPARA"

KOHA PËR TA KAPUR TRENIN PËR NË BE



RESPEKTOHEN REKOMANDIMET E KOMISIONIT TË VENECIAS PËR REFERENDUMIN

Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, deklaroi se respektohen plotësisht rekomandimet e Komisionit të Venecias në lidhje me përfshirjen e zyrtarëve qeveritarë në fushatën për referendumin e ardhshëm. "Aktivitetet tona të përditshme janë të lidhura me interesin strategjik të vendit dhe kështu kanë qenë 27 vitet e fundit që nga pavarësia e Maqedonisë. Ne nuk kemi një Qeveri që nuk kishte

prioritet dhe interes për pranimin e Maqedonisë në NATO dhe në BE. Qeveria ka ndarë 400 mijë denarë për të promovuar përfitimet e anëtarësimin në NATO dhe në BE në rrjetet sociale dhe këtë do ta bëjmë brenda aktiviteteve aktuale", tha Boshnjakovski, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve në një konferencë të rregullt për shtyp në qeveri.

gim të ndëroni emrin kushtetues të vendit, ajo paraqet çështje të ndjeshme, por të inkurajuar për shkak të përfitimëve, besojmë se shënojmë moment të rëndësishëm edhe nga historia evropiane që do të konfirmohet me shumicë të madhe në referendumin e ardhshëm", tha kryeministri Zaev.

Ernst Shteter, sekretar i përgjithshëm i Fondacionit për Studime Progressive Evropiane tha se krahas të gjithave që janë bërë

në periudhën e fundit hap shumë i madh ka qenë guximi të zgjidhet kontesti i emrit. Me qëndrimin e tillë pajtohet edhe Marija Zhoao Rodrigues kryetare e Fondacionit, duke potencuar se në momente të tilla historike nevojitet unitet i të gjitha subjekteve dhe qytetarëve.

Tema të konferencës janë ndryshimet socio-ekonomike dhe politike në shtet pas ndryshimit të pushtetit, integrimi në BE dhe NATO dhe roli i partnerëve ndërkombë-

tar dhe kontributi i tyre drejt zhvillimit të mëtutjeshëm të Maqedonisë dhe Evropës Juglindore, që e organizojnë Progres-Instituti për demokraci sociale në bashkëpunim me Fondacionin për studime progresive evropiane, Qendra ndërkombëtare "Olof Palme", Fondacioni Vestminster pranë Partisë laboriste nga Britania e Madhe, Fondacioni "Fridrih Ebert" - Zyra Shkup dhe Forumi evropian për demokraci dhe solidaritet.



Vetëm Ballkani evropian është Ballkan stabil

Vjenë, 31 gusht - Vizioni i vetëm i qëndruar për një Ballkan stabil është Evropa e bashkuar. Të gjithë punojmë në reformat për demokraci dhe qeverisje të së drejtës me qëllim që ta ndajmë së bashku Evropën e ardhshme pa kufij. Është koha për ne, për rajonin dhe për vendet anëtare ta bëjmë hapin drejt këtij vizioni, shkroi ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov në Twitter, pas përfundimit të takimit joformal të shefave të diplomacive të BE-së dhe vendeve kandidatë në Vjenë. Në takimin joformal, ministri midis tjerash porositi edhe se për rajonin e Ballkanit shpesh mendohet si për periferinë e Evropës, ndërsa ai është i rrethuar me vende anëtare. Prandaj, porositi se në rajon janë zgjidhur pothuajse të gjitha çështjet e hapura dhe se shembulli i fundit për këtë është zgjidhja kontestit për emrin midis Maqedonisë dhe Greqisë. "Përsheptimi dhe revitalizimi i procesit të zgjerimit e ka kuptimin e tij. Për Evropën është më mirë dhe më lirë të investojë edhe prej rajonit, me ndihmën tonë, të bëjë rajon evropian, sesa ta injorojë, që në fund do të jetë shumë shtrenjtë", porositi Dimitrov. Shefi i diplomacisë së Maqedonisë potencoi se vendet e Ballkanit Perëndimor janë fuqimisht të vendosura të kenë sukses në procesin e eurointegritimeve, pasi, theksoi, "në pritje humbi një gjeneratë e tërë".

VAZHDOJNË REAGIMET KUNDËR MINISTRISË SË DREJTËSISË

LIGJI PËR ANTI-KORRUPSION PA KONSULTIM ME SEKTORIN CIVIL

Shkup, 31 gusht - Propozim-ligji i ri i Ministrisë së Drejtësisë për parandalimin e korrupsionit ka shkaktuar reagime të shumta nga organizatat joqeveritare. Ministria e Drejtësisë, Renata Deskoska, një ditë më parë e publikoi propozim-ligjin e ri për parandalim të korrupsionit pa u konsultuar paraprakisht me grupin punues, të cilët kanë qenë ekspertë të fushës dhe përfaqësues të sektorit civil. Anëtarët e grupit punues për këtë propozim-ligji thonë se nuk kanë qenë të njoftuar se do të prezantohet ligji dhe se nuk janë bërë ndërhyrjet përkatëse për të cilat ata kanë punuar. "Nuk kemi qenë të njoftuar, por nuk do të mund t'u

japë deklaratë për atë se çfarë ka ndodhur, presim që të na njoftojë Ministria e Drejtësisë dhe pastaj do të ju tregojmë se cili është qëndrimi ynë", thotë Dançe Dellovska, nga Fondacioni Shoqëri e Hapur.

Edhe Ana Deleva nga Transparencë Maqedoni, thotë se Ministria e Drejtësisë e ka publikuar propozim-ligjin edhe pse nuk i kanë njoftuar paraprakisht për të njëjtin. "Nuk na kanë njoftuar, ata e publikuan propozim-ligjin a grupi punues ka pasur të caktuar takim më 4 shtator. Disa pjesë të ligjit për të cilët kemi punuar fare nuk janë ndryshuar", thotë Deleva.

Reagime ka pasur edhe në rre-

tet sociale, sidomos në pjesën e nenit 49 të propozim-ligjit për parandalim të korrupsionit, i cili fare nuk është ndryshuar, edhe pse gjatë takimeve të grupit punues, është kërkuar që i njëjti të ndryshohet ose fare të fshihet. Sipas të njëjtit, Komisioni për Antikorrupsion, ka kompetencë që të bëjë kontrolle financiare edhe ndaj organizatave qytetare dhe fondacioneve, edhe pse ato nuk punojnë me para publike, gjegjësisht të buxhetit. "Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit (Anti-Korrupsioni) ka kompetencë për ngritjen e iniciativës përpara organeve kompetente për kontroll të punës materiale-



financiare të partive politike, sindikatave dhe organizatave civile dhe sindikatave", shkruhet në nenin në fjalë. Ndryshe, kontrolli financiar i organizatave dhe fondacioneve ka qenë mekanizëm i ish pushtetit të VMRO-DPMNE-së në krye me Nikolla Gruevskin, i cili pak

përpara se të rrëzohej nga pushteti filloi fushatë kundër sektorit civil, duke i akuzuar për shpëlarje parash. Për këtë, të afërmit e partisë së tij, madje formuan dhe organizatë për "desorosizim" të Maqedonisë. Asokohe, sektori civil ankohej se inspektorët e MPB-së, Policisë Financiare dhe të Drejtorisë për të Ardhura Publike, po u bëjnë presion në punën e tyre duke bërë kontrolle të përditshme, me qëllim që të "gjenet qime në vezë". Pas ardhjes në pushtet të LSDM-së, MPB, Policia Financiare dhe DAP, njoftuan se nuk kanë gjetur asgjë të dyshimtë nga kontrollet që u janë bërë organizatave civile. (portalb)

“Pothuajse për çdo vit po shndërrohem në popullatë tepër të stresuar, po bëjmë një jetë shumë dinamike, nuk përdorim ushqime të shëndetshme apo kemi probleme me kilogramët e tepërt. Të gjitha këto fenomene kanë të bëjnë me faktin se qytetarët realizojnë më shumë receta që kanë të bëjnë me sëmundjet kardiovaskulare. Gjithashtu kemi dhe rritjen e numrit të rinjve që kanë probleme me stresin e që çon nga viti në vit në rritjen e të rinjve që konsumojnë ‘Diazepam’”, thonë nga FSHM-ja

MBI 23 MILIONË RECETA PËR NJË VIT

GJYSMA ME “DIAZEPAM”



tepërt. Të gjitha këto fenomene kanë të bëjnë me faktin se qytetarët realizojnë më shumë receta që kanë të bëjnë me sëmundjet kardiovaskulare. Me tension të lartë të gjakut nuk kanë problem vetëm të moshuarit, por viteve vetë fundit është rritur edhe numri i të rinjve që kanë probleme me tensionin e lartë të gjakut. Gjithashtu kemi dhe rritjen e numrit të rinjve që kanë probleme me stresin e që çon nga viti në vit në rritjen e të rinjve që konsumojnë ‘Diazepam’”, thonë nga FSHM-ja.

Ndryshe, numri i recetave të realizuara që shkruhen nga mjekët amë nga viti 2007 e deri në fund të vitit 2017 vazhdimisht po rritet. Derisa në vitin 2008 qytetarët e Maqedonisë kanë realizuar 10.283.273 receta, për nëntë vite numri i recetave të realizuara është dyfishuar dhe në vitin e kaluar janë realizuar 23.090.780 receta. Nëse kemi parasysh të dhënat e FSHM-së se vitin e kaluar janë regjistruar 1.872.466 persona të siguruar, i bie që mesatarisht një i siguruar të ketë realizuar 12 receta brenda vitit. Këtë vit, për realizimin e këtyre recetave, FSHM-ja ka shpenzuar 21.4 milionë euro, kurse vitin e kaluar ka dyfishuar shpenzimet të cilat kanë shkruar në vlerën e përgjithshme prej 45.3 milionë euro.

sheqerit në gjak, barna kundër reumatizmit, gjegjësisht ilaçe për të cilat harxhimet i mbulon shteti.

Këto janë edhe top dhjetë barnat që më së shumti i kanë marrë qytetarët e Maqedonisë nëpër barnatoret e për të cilat siguresit e FSHM-së kanë paguar vetëm participimin. Si ilaç që më së shumti e kanë përdorur siguresit e FSHM-së është ‘Enalapril’ (ilaç për tensionin e lartë të gjakut) dhe mjekët amë gjatë vitit 2017 kanë lëshuar 2.080.620 receta. Si ilaç i dytë që më së shumti është lëshuar nga mjekët amë është ‘Metformin’ (ilaç për rregullimin e nivelit të lartë të sheqerit në gjak), edhe atë 1.246.965 receta të realizuara,

ndërsa ‘Diazepami’ është ilaçi i tretë që mjekët amë ua kanë rekomanduar qytetarëve për qetësim me gjithsej 1.124.406 receta.

Pas këtyre tre ilaçeve, me rekomandimet të mjekëve amë si ilaçi katërt me radhë që qytetarët e kanë përdorur është ‘Lizinopril’, gjithashtu terapi kundër tensionit të lartë të gjakut, në vendin e pestë është ‘Bisoprolol’ i cili jepet për rregullimin e rrahjeve të zemrës. Në vendin e gjashtë është radhitur ‘Pentoksifilin’ që përdoret nga personat që kanë probleme me qarkullimin e gjakut apo personat që i kanë mbijetuar goditjes në tru.

Në vendin e shtatë radhitet ilaçi ‘Atorovastatin’. Ilaçi që radhi-

tet në vendin e tetë është ‘Losartan’, po ashtu kundër tensionit e lartë të gjakut. Në vendin e nëntë radhitet diuretiku ‘Hidrohlortiazid’ dhe në vendin e dhjetë është ilaçi kundër dhimbjeve reumatike ‘Diklofenak’. Sipas FSHM-së, është shumë e logjishme që mjekët amë shkruajnë më shumë ilaçe për mjekimin e sëmundjeve kardiovaskulare për shkak se në Maqedoni, dhjetë vitet e fundit kemi popullatë që po plaket.

“Pothuajse për çdo vit po shndërrohem në popullatë tepër të stresuar, po bëjmë një jetë shumë dinamike, nuk përdorim ushqime të shëndetshme apo kemi probleme me kilogramët e

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 31 gusht - Në vitin 2017, mjekët amë kanë shkruar gjithsej 23.090.780 receta dhe atë 9.781.742 receta për 10 barnat më të kërkuara nga qytetarët e Maqedonisë që janë në listën pa pagesë, si dhe 13.309.038 receta për barna tjera. Sipas të dhënave të fundit të Fondit Shëndetësor të Maqedonisë (FSHM), mjekët amë pas kryerjes së kontrolleve mjekësore-pacientëve më së shumti u kanë shkruar receta që kanë të bëjnë me terapinë e uljes së tensionit të lartë të gjakut, për qarkullimin e gjakut, normalizimin e nivelit të lartë të

KORRIGJOHEN 22 TEKSTE TË CIKLIT FILLOR

Libra fringo për nxënësit më të vegjël

Gjatë këtij viti pritjet që të botohen me tirazh të plotë dhe përmbajtje të korrigjuar tekstet e lëndëve si Matematika, Shkencat natyrore, Biologjia, Kimia dhe Fizika. Ndërsa librat e tjerë, si Historia, Muzika..., dhe përmbajtjet ofenduese dhe me stereotipie ndaj shqiptarëve do të shqyrtohen më vonë

para, të dyta dhe të treta do të pajisen me komplete të reja librash, çdo vit shkollor. Risitë pak ditë përpara vitit të ri shkollor janë kumtuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndonëse nuk kanë dhënë një datë se kur do të dalin nga shtypi librat e rinj të korrigjuar. Gjatë këtij viti pritjet që të botohen me tirazh të plotë dhe përmbajtje të korrigjuar tekstet e lëndëve si Matematika, Shkencat natyrore, Biologjia, Kimia dhe Fizika. Ndërsa librat e tjerë, që për disa vite me radhë kanë krijuar kaos dhe revolt tek pjesa shqiptare si Historia, Gjeografia, Edukata qytetare, Muzika..., e të tjera do të vazhdojnë të mësohen edhe këtë vit me të njëjtën përmbajtje. Supozohet se ky do të jetë grupi i dytë i librave që do t'i nënshtrohen procesit të korrigjimit, dhe sipas ministrit Arbër Ademi për disa libra vecme ka filluar procesi i vlerësimit nga komisionet adekuate. Nj tjetër risi nga ky vit është që të gjitha librat që MASH i siguron falas për nxënësit, po ashtu do të jenë në shitje, me

çmimin e njëjtë me të cilin i blen Ministria.

“Sa i takon nxënësve deri në klasë të tretë do të pajisen me komplete librash tërësisht të reja, me qëllim që si ata, ashtu edhe prindërit e tyre të mos shqetësohen se do të pajisen me libra të përdorur, pjesërisht të dëmtuar, të cilët edhe mund të ndikojnë negativisht në motivimin për të mësuar”, ka thënë ministri Ademi. Sa i takon teksteve shkollore për arsimin e mesëm ka filluar procesi për përpilimin e 31

librave të arsimit profesional, ndërsa dy tekste të tjera ekzistuese, Biologjia për vitin e parë dhe Etika për vitin e tretë do të korrigjohen. Korrigjimet e librave të parë janë bërë edhe pas realizimit të anketave nga MASH me mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme, por edhe në bashkëpunim me autorët dhe shtëpitë botuese. Sipas Drejtoresha e shërbimit pedagogjik, Vanja Veleva, tha se procesi gjithëpërfshirës i korrigjimit të të gjithë librave kërkon kohë, por detyra primare

është që të gjithë së bashku të kontribuojnë për arsimin cilësor, që është dhe do të jetë prioritet i këtij institucioni. Ndërsa Magdalena Vlaisllivleviq nga Komisioni për korrigjimin e librave të Biologjisë ka thënë se nga këto tekste janë eliminuar shumë gabime kryesisht drejtshkrimore dhe përkthimit të tyre. Por po ashtu janë korrigjuar edhe shumë terma shkencore që figuronin të pasqaruara si duhet dhe si të tilla të vështira për t'u nxënë nga nxënësit.

KUMANOVË, SIVJET 1265 NXËNËS MË PAK SE VJET

Në pesë shkollat e mesme të Kumanovës në vitin e parë do të fillojnë 1265 nxënës që është pak më pak në krahasim me vitin e kaluar, informojnë nga Sektori për arsimin e komunës së Kumanovës. Interes më të madh ka për drejtimin mjekësor nga shkollat profesionale dhe për gjimnazet, ndërsa interesi më i vogël është për drejtimin e tekstit. Në shkollën e mesme ‘Pero Nakov’ këtë vit në vitin e parë janë regjistruar 141 nxënës që është më pak në krahasim me vitin e kaluar kur ishin regjistruar 192 nxënës. Zvogëlim të dukshëm të numrit të nxënësve të regjistruar në këtë shkollë të mesme ka në paralelet ku mësimi realizohet në gjuhën shqipe. Numër dukshëm më i vogël i

nxënësve ishin regjistruar në shkollën e mesme profesionale ‘Nace Buxhoni’ - 508 ku vitin e kaluar në vitin e parë kishin filluar 514 nxënës. “Edhe krahas numrit të vogël të nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme, do të formohen paralele dhe do të angazhohet kuadër i përhershëm”, deklaroi udhëheqësi i Sektorit për arsim Zhika Kërstevski. Në shkollën e mesme profesionale ‘Kiro Burnaz’ këtë vit ishin regjistruar 131 nxënës që është për shtatë nxënës më shumë në krahasim me vitin e kaluar, përderisa në gjimnazin ‘Sami Frashëri’ ka tre nxënës më shumë, ndërsa në gjimnazin ‘Goce Dellçev’ ishin regjistruar 33 nxënës më shumë se viti i kaluar.

Koha Evis HALILI

Shkup, 31 gusht - 22 tekste shkollore të korrigjuara nga gabimet profesionale, metodologjike, përkthimit dhe përshtatjes do të vihen në qarkullim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës gjatë këtij viti shkollor. Ndërsa nxënësit e klasave të

“MONSTRA”, PËRFUNDOI MARRJA NË PYETJE E DËSHMITARIT TË FSHEHTË

DËSHMITAR I FSHEHTË NDRYSHON RRËFIMIN



Avokati i mbrojtjes, Naser Raufi, theksoi se ekzistojnë indikacione me të cilat konfirmohet se dëshmitari i rrezikuar është "dëshmitar i rrejshëm"

Shkup, 31 gusht - Gjykimi për rastin "Monstra" i Prokurorisë Speciale Publike për vrasjen e pesëfishtë tek Liqeni i Smilkovës nga 12 prilli i vitit 2012 ka vazhduar edhe me marrjen në pyetje të dëshmitarit të fshehtë, në kuadër të procedurës dëshmuese. Fejzi Aziri, njëri prej të aku-

zuarve, i shtroi disa pyetje dëshmitarit të fshehtë të cilat kishin të bëjnë me kohën në të cilën, siç pohoi dëshmitari, e ka vërejtur Azirin në vendin e krimit.

Pastaj, Aziri u përqendrua në përgjigjet e dëshmitarit të mbrojtjes nga dëgjimet paraprake, me çka konstatoi se dëshmitari i fshehtë për herë të parë ka theksuar se përveç asaj që ka parë trupa, për të cilat nuk ka dhënë më shumë detaje, ka dëgjuar edhe të shtëna tek Liqeni i Smilkovës në ditën e ngjarjes. Prokurorja Fatime Fetaj theksoi se dëshmitarit të fshehtë paraprakisht nuk i është

shtuar pyetje konkrete lidhur me dëshminë për të shtënat.

Gjykata i shtroi disa pyetje dëshmitarit për dy automjetet, të cilat, sipas pohimit të tij, ai i ka vërejtur, përveç automjetit "Golf 3", në vendin e ngjarjes në ditën e vrasjes së pesëfishtë, si dhe detaje nga rrethanat nga Liqeni i Smilkovës në atë periudhë. Marrja në pyetje e dëshmitarit të fshehtë përfundoi, ndërsa gjykatësi Ognen Stavrev theksoi se në margjinat e procedurës dëshmuese vijuese do të jetë inspektimi i automjetit "Golf 3", për çka Fetaj rekomandoi që edhe opinioni të jetë i

përfshirë. Avokati i mbrojtjes Naser Raufi theksoi se ekzistojnë indikacione me të cilat konfirmohet se dëshmitari i rrezikuar është "dëshmitar i rrejshëm". "Ky dëshmitar është i rremë, definitivisht kjo u dëshmuar edhe sot, këtë e pohoj edhe nga arsytet që ka një sasi të madhe të dallimeve në shprehjet e tij, ai tani më për të tetën herë vjen këtu", theksoi Raufi. Për rastin akuzohen Agim Ismailoviq, Haki Aziri, Sami Luta dhe Fejzi Aziri, si dhe Alil Demiri dhe Afrim Ismailoviq për të cilët është kërkuar ekstradim nga Kosova. (O.Xh)

Aksident në Vajlkal, lëndohen katër dibranë

Dibër, 31 gusht - Katër qytetarë nga Dibra e Maqedonisë kanë mbetur të plagosur si pasojë e një aksident që ka ndodhur në segmentin e Rrugës së Arbërit në vendin e quajtur Vajlkal. Sipas policisë një automjet Citroen me targa të Maqedonisë SU 324 SB, e cila po udhëtonte drejt Tiranës ka dalë nga rruga dhe si pasojë u plagosën rëndë 4 persona që ndodheshin në makinë. Sipas policisë, e cila ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes, shkak i aksidentit mendohet të ketë qenë shpejtësia e madhe e drejtuesit të automjetit. Aksidenti ka ndodhur pikërisht në vendin ku është dëmtuar edhe rruga e Arberit, si pasojë e lëvizjes së tokës. Të aksidentuarit ndodhen në spitalin e Bulqizës, ku dy prej tyre janë nisur me ambulancë në drejtim të Spitalit Ushtarak për mjekim më të specializuar. Po punohet për zbardhjen e rrethanave të aksidentit.

Për dy vjet, 82 raste të mbidozës me drogë

Shkup, 31 gusht - Nga janari i vitit 2016 deri në qershor të këtij viti, 82 raste të mbidozës janë regjistruar në Klinikën Universitare për Toksikologji prej të cilave 11 ishin gra, ndërsa një adoleshent. Nga rastet 36 janë rezultat i mbidozës me heroinë, ndërsa 46 me metadon. Kjo citohet në kumtesën e përbashkët të Shoqatës HOPS - Opsionet për jetë të shëndetshme, Klinika për Toksikologji dhe Shoqata e toksikologëve të Maqedonisë me rastin e Ditës Ndërkombëtare për ndërgjegjësimin kundër mbidozës me droga. Potencohet se numri real i rasteve të mbidozës me siguri është shumë më i madh. Shërbimet e Ndihmës së shpejtë mjekësore, shërbimet mjekësore kujdestare dhe Qendrat urgjente edhe gjatë dyshimit më të vogël të mbidozës me ekstaza duhet ta përdorin preparatin Nalokson, i cili duhet të bëhet i arritshëm në bashkësitë të cilat përdorin droga ekstaza. Kompanitë farmaceutike të cilat e prodhojnë dhe përfaqësuesit e tyre ligjor duhet ta regjistrojnë ilaçin, ndërsa Ministria e Shëndetësisë të lejojë qarkullim të lirë të të njëjtit pa recetë, me çka ai do të mund të blihet në barnatorët, theksohet në kumtesë. Ministria e

Drejtësisë, sërish, siç potencon, duhet të gjejë zgjidhje për ndërprerje të praktikës së lëshimit të të burgosurve pa dokumentacion adekuat, sepse me atë parandalohet ata persona të vazhdojnë me shërimin e varësisë menjëherë pas daljes në liri, që i vë në rrezik të veçantë nga mbidoza. Klubet dhe të gjithë organizatorët e ngjarjeve muzikore dhe ngjarjeve të tjera në mënyrë masive duhet të vendosin masa për mbrojtje të shëndetit dhe jetës së vizitorëve, si dhe sigurim të qasjes së pandërprerë të Ndihmës së Shpejtë Mjekësore në podiume, ujë falas në ngjarje, si dhe prani të ekepeve të trajnuara për zvogëlimin e dëmeve në çdo ngjarje. Institucionet kompetente duhet të vendosin sistem efikas për evidentim të rasteve të mbidozës. Njerëzit të cilët kanë për qëllim të shfrytëzojnë çfarëdo lloj droge duhet të informohen për veprimin, pasojat e mundshme, si dhe mënyrat për zvogëlimin e dëmeve. Qytetarët në rast të dyshimit të mbidozës në rrethinën e tyre menjëherë ta japin ndihmën e parë dhe t'i telefonojnë Ndihmës së shpejtë mjekësore, qëndron në kumtesë. Çdo vit rreth 20.000 njerëz në botë janë viktimë të mbidozës.

KRONIKË

Shkup, 32 vjeçari theret me thikë

Shkupjani A.Sh. (32) mbrëmë, rreth orës 19, me thikë ishte goditur në shpinë nga personi A.S. nga Shkupi në bulevardin "8-të Shtatori". Siç bëri të ditur MPB-ja, A.Sh. në orën 21:30 minuta, e kishte denoncuar rastin në Stacionin Policor të Karposhit. Mbrëmë A.Sh. me shokun e tij E.Sh. ngjasin biçikletë, ndërsa afër tyre ishte afuar vetura "Ford" me targa regjistrimi të panjohura, në të cilën gjendej A.S. dhe katër persona të panjohur. Përderisa vetura ishte në lëvizje, A.S. e kishte hapur dritaren dhe me thikë e kishte goditur A.Sh. në shpinë, ndërsa e kishte goditur edhe shokun e tij. Policia ndërmori masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Preshevari aksidentohet në Mavrovë

Në rrugën regionale Mavrovë-Dibër në vendin quajtur "Zhirovničko Ançe", të enjten rreth orës 10.45 minuta, një veturë e tipit "Mercedes Benz", me targa të Serbisë të cilën e ka drejtuar 72-vjeçari me iniciale XH.A nga Presheva, i cili ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe për pasojë ka goditur në një shtyllë metalike të urës. Nga goditja, vozitësi si dhe bashkudhëtarja e tij, gjegjësisht bashkeshortja me iniciale R.A. 74-vjeçare, kanë marrë lëndime trupore dhe pas marrjes së ndihmës së parë mjekësore në ambulancën e Rostushës, janë dërguar në spitalin e Dibrës ku janë mbajtur për shërim të mëtutjeshëm. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe po vërtetohet shkaku i këtij aksidenti, rrethanat në të cilat ka ndodhur dhe gjithçka tjetër që ndërlihet me aksidentin në fjalë.

Me frena të dëmtuara transportojnë udhëtarë

Në rajonin më të gjerë të Tetovës dhe Gostivarit, të enjten është realizuar një aksion kontrolli për gjendjen teknike të automjeteve që qarkullojnë në këtë rajon para së gjithash të automjeteve që kryejnë transport publik të udhëtarëve gjegjësisht autobusëve dhe furgonëve. Në këtë aksion kontrolli gjithsej janë përfshirë 115 automjete, në Tetovë 75 dhe në Gostivar 40, prej të cilave 81 që kane kryer transport publik, në Tetovë 53 dhe Gostivar 28. Me këtë rast, nga pjesëtarët e policisë të Sektorit për Punë të Brendshme Tetovë janë zbuluar 18 kundërvajtje në Tetovë 8 dhe Gostivar 10, më shumë me frena të dëmtuar në Tetovë 6 dhe Gostivar 2, si dhe pajisje të tjera të dëmtuara. Mangësitë e konstatuara tek automjetet nga ky aksion kontrolli janë rrrbul-lakësuar, gjegjësisht janë sanksionuar sipas ligjit me 18 fletëpagesa për gjobë në Tetovë 8, Gostivar, 10, 11 automjete janë përjashtuar nga komunikacioni në Tetovë 6 në Gostivar 5, si dhe më një kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse. (U.H)

VAZHDON PROCESI GJYQËSOR PËR 27 PRILLIN

DHUNUESIT NA DONIN TË VDEKUR

"Prej se Zijadin Sela ra dhe e festuan fitoren, turma filloi të bëjë litar nga kabllot e pajisjeve që të na varin. Askush nga sigurimi i Parlamentit nuk është munduar të na dërgojnë në vend më të sigurt derisa ka zgjatur ngjarja", tha Mançevski në dëshminë e tij që zgjati rreth katër orë



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 31 gusht - Të gjithë 33 të akuzuarit për ngjarjet më 27 prill në Parlamentin e Maqedonisë ishin të pranishëm në seancën e djeshme gjyqësore në Gjykatën Penale në Shkup, në të cilën dëshmuar katër dëshmitarë të Prokurorisë, konkretisht ministri Damjan Mançevski dhe deputetët Frosina Remenski, Pavle Bogoevski dhe Ilija Nikolovski. Para Trupit gjykues, Mançevski tha se më 27 prill ka qenë në pres sallën e Parlamentit së bashku me Zoran Zaevin dhe deputetët tjerë dhe se kur turma ka hyrë në pres qendër, ka vërejtur një njeri me bluzë të zeze dhe shenjë të "HOS" (Forcave të Armatosura Kroate), i cili ka mbajtur armë.

"Turma e hapi derën. Një grup i madh i njerëzve u nis drejt nesh dhe filloi të godasë me duar, karrige, tastatura, stativat e kamerave, dhe gjithçka që gjetën para vetes, si dhe me shkopinj të flamujve që i kishin me vete. E pashë një person me armë. Ai mbante bluzë të zeze me shenja të HOS (FAK) pa flokë dhe me mjekër në atë moment", tha Mançevski në dëshminë e tij që zgjati rreth katër orë. Disa herë, sqaroi Mançevski, kam mundur të shoh se personi zgjatet për t'u kapur në pjesën e pasme të pantallonave dhe dorën e mbante tek arma.

"Asnjëherë nuk e nxori të tërën, por gjatë tërë kohës derisa ka zgjatur ngjarja, kemi marrë kërcënime se do të vritemi, që mua personalisht ma tregon qëllimin e tërë grupit", ka dëshmuar Mançevski, duke shtuar se njeriu me armë nuk ka qenë aq

aktiv si të tjerët, por që gjatë tërë kohës ka qenë i fokusuar me shikim drejt Zaevit. Ministri i Administratës dhe Shkencave Kompjuterike tha se ka pasur përshtypje që edhe personat e tjerë mbajnë armë, por që nuk ka parë ndonjë person tjetër me armë. Mançevski ka dëshmuar se gjatë tërë kohës ka marrë kërcënime me jetë dhe se do t'i vrasin, pas "e kemi shitur shtetin dhe se jemi tradhtarë". Para Gjykatës, Mançevski tha se është goditur me grusht në pjesën e hundës dhe se hunda i është thyer. Rrëfeu gjithashtu se gjatë tërë kohës është goditur me shuplaka dhe me stativa të kamerave dhe ombrellë, të cilën pastaj e ka blerë nga personi që e ka goditur për 1000 denarë.

"Prej se Zijadin Sela ra dhe e festuan fitoren, turma filloi të bëjë litar nga kabllot e pajisjeve që të na varin.

Askush nga sigurimi i Parlamentit nuk është munduar të na dërgojnë në vend më të sigurt derisa ka zgjatur ngjarja", tha Mançevski. I pyetur se si ka reaguar sigurimi parlamentar, Mançevski tha se ka dëgjuar se si shefi i sigurimit të Parlamentit në telefon është munduar ta marrë dikë, por pastaj komenti i tij ka qenë: "kemi mbetur vetëm". Të akuzuarit në rastin për ngjarjet e 27 prillit akuzohen për kërcënim terrorist ndaj rendit kushtetues. Ata në seancat gjyqësore parapake në Gjykatën Penale thanë se e kuptojnë akuzën, por nuk ndjehen fajtor. Procesi gjyqësor filloi më 22 gusht me fjalët hyrëse të avokatëve të prokurores Vilma Ruskoska dhe avokatët e të akuzuarve. Prokurorja Ruskoska deklaroi në fjalët hyrëse se ka prova që do të konfirmojnë pretendimet e akuzës për kryerjen e një veprë penale "kërcë-

nim terrorist ndaj rendit kushtetues", ndërsa mbrojtja argumenton se nuk ka prova për të vërtetuar këtë.

Në bankën e të akuzuarve në gjykatë janë Luben Arnaudov, Sasho Vasilevski, Kërsto Mukoski, Lupço Dimovski, Johan Tarçulovski, Mitko Çavkov Mitko Peshovski, Dushko Lazarov, Goran Joshevski - Levi Oliver Popovski, Oliver Radullo, Sasho Markovski, Munir Pepiq, Abdulfeta Alimi, Elena Docevska - Bozhinovska, Ivan Cvetanovski Boris Damovski, Bogdan Ilievski - Betmen, Vllado Jovanovski, Igor Durllovski, Stefan Mladenovski, Mihail Mladenovski, Zakaria Simovski, Mladen Dodevski, Jane Çento, Goranço Angellovski, Igor Jug, Ilija Sllaveski, Vlatko Trajkov, Viliam Mihajilovski, Nikolla Mitrevski - Koljo, Aleksandar Vasilevski - Ninxa dhe Mitre Pitropovski.

REFUZOHEN KËRKESAT E MBROJTJES SË GRUEVSKIT

Refuzohen kërkesat për përjashtim të Këshillit gjyqësor dhe u.d. kryetares së Gjykatës së Apelit, Lidija Dimçevska, që i parashtrori mbrojtja e të dënuarve në lëndën "Tanku", Nikolla Gruevski dhe Gjoko Popovski. Pas kumtimit të këtyre vendimeve, seanca publike e Gjykatës së Apelit në të cilën po vendoset për ankesat për dënimet me burg të Gruevskit dhe Popovskit, sërish është ndërprerë. Avokati Sterjo Zikov kësaj here kërkoi përjashtim të gjykatës raportuese Tanja Mileva për shkak se, siç theksoi, ajo është zgjedhur në kohën kur LSDM-ja formonte Qeveri, ndërsa PSP i ka hapur lëndët për të cilat zhvillonte hetim. Sipas Zikovit, nëse mbetet, gjykatësja Mileva



do të jetë jo-objektive. Zikov tha se Mileva është bashkëshorte e Igor Milevit i cili ishte kandidat për kryetar të komunës së Radovishit nga LSDM-ja, ishte anëtar i KSHZ-së nga LSDM-ja, ndërsa tani është këshilltar i drejtorit të Drejtorisë Doganore. Kryetarja e Këshillit gjyqësor Cvetanka Periq sërish dha pauzë që të dorëzohet kërkesa e Zikovit për përjashtim të Milevës deri te u.d. kryetarja e Gjykatës së Apelit Lidija Dimçevska. Për rastin "Tanku", ish-kryeministri Nikolla Gruevski si nxitës për kryerje të veprës është dënuar me dy vjet burg, ndërsa ish-ndihmësiministri në MPB, Gjoko Popovski me gjashtë vjet e gjashtë muaj burg.

Edhe në Kërçovë do të jepen vërtetime mjekësore

Drejtoresha e Spitalit të Përgjithshëm të Kërçovës, Biljana Nasteska, informoi se pas një periudhe të gjatë në Spitalin e Përgjithshëm të Kërçovës do të mund të merren vërtetime mjekësore. Para pothuajse gjashtë muajve, Inspektorati sanitar republikan solli vendim që të ndalohej dhënia e vërtetimeve mjekësore për shkak të mos plotësimit të kushteve higjienike-tekhnike në Spitalin e Përgjithshëm të Kërçovës. "Në insistimin tim, përfundimisht pas një periudhe të gjatë edhe në spitalin e Kërçovës do të mund të merren vërtetime mjekësore. Pas të gjitha kontrolleve të kryera nga ana e shërbimeve kompetente inspektuese dhe ministrisë dikasteriale, është dhënë dritë e gjelbër dhe për marrjen e vendimit të nevojshëm, bashkëqytetarët tanë më nuk do të kenë nevojë për këtë dokument të udhëtojnë në qytetet përreth", theksoi Nasteska, Ajo theksoi se në spital, gjithashtu, zbatohet edhe ekipimi kuadrovik. "Nga specializimi kthehet oftalmologu, ndërsa specialistët e tjerë të nevojshëm vijmë nga Prilepi dhe nga qytetet e tjera, por nga shtatori do t'i kemi edhe ata specialistë, ashtu që, tërësisht të ekipuar, në një të ardhme të afërt do të mund të përgjigjemi në këto obligime", sqaroi Nasteska. Ajo paralajmëroi se ekipimi kuadrovik do të plotësohet me punësim të reja të mjekëve të cilët do të dërgohen në specializim adekuat. (D.K)

Gazsjellësi në Vodno, dorëzohet Qeveria dhe Qyteti i Shkupit

Shkup, 31 gusht - Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, i ftoi në debat përfaqësuesit e organeve kompetente shtetërore për ndërtimin e gazsjellësit në Vodno, si dhe përfaqësuesit e shoqatave qytetare të cilët treguan shqetësim. Debatit do të mbahet të hënën (3 shtator) në orën 13:00 në hapësirat e Këshillit të Qytetit

të Shkupit. Ai informoi se janë ndërprerë të gjitha aktivitetet ndërtimore për ndërtimin e gazsjellësit në Vodno deri në përfundimin e procesit të dialogut dhe debatit.

"Ndërtimi i gazsjellësit në Vodno shkaktoi shqetësim dhe reagime në opinion.

para fillimit të aktiviteteve ndërti-

more vijuan bisedime intensive me aktivistët dhe me qytetarët e shqetësuar dhe u kërkuan zgjidhje të përbashkëta alternative me kompromis.

Pikërisht si rezultat i këtyre bisedimeve arritëm të luftojmë për zvogëlimin e gjerësisë së trasës së gazsjellësit prej 25 në 10 metra dhe ndryshime të trasës në një

pjesë prej katër kilometrave. Por edhe krahas kësaj, është e dukshme se në opinion ende ekziston shqetësim për një trasë të tillë dhe për ndërtimin e gazsjellësit. Për këto arsye Qyteti i Shkupit vendosi të hënën në orën 13.00 në hapësirat e Këshillit të Qytetit të organizojë dialog dhe debat", shtoi Shilegov.



NJË PROJEKT KAPITAL PËR TETOVËN DHE GOSTIVARIN

HIDHET GURTHEMELI I SISTEMIT TË UJITJES PËR POLLOG

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, kërkoi nga ana e Qeverisë respektimin e afateve për realizimin e këtij projekti, me qëllim që, siç tha ai, në Pollog të prodhohet ajo sasi dhe cilësi e produkteve bujqësore siç ka qenë në të kaluarën kur fusha e Pollogut ishte konkurrent kryesor me produkte në nivel Ballkanik dhe kishte një vend meritor



Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 31 gusht - Në Tetovë është hedhur gurthemeli për ndërtimin e sistemit të ujitjes së tokës pjellore Raven-Reçicë. Në fillimin e punimeve për realizimin e këtij projekti kapital, ka marrë pjesë edhe vet kryeministri Zoran Zaev i shoqëruar nga zëvendëskryeministri për çështje ekonomike, Koço Angjushhev, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, ministra dhe përfaqësues të Qeverisë. Zaev i fjalën e tij theksoi se realizimi i këtij projekti kapital financohet me mjete nga Buxheti i Qeverisë e që kap shumë prej 975 milionë denarë apo mbi 15 milionë euro.

"Nga ky sistem i ujitjes, që përfshin një hapësirë prej 3920 hektarë tokë bujqësore, do të ujitet toka bujqësore që shtrihet në pjesën e epërme të autostradës Te-

tovej-Gostivar deri në periferi të Malit Sharr. Përveç kësaj sipërfaqe bujqësore, me këtë sistem të ujitjes do të përfshihet edhe sipërfaqja e tokës bujqësore që gjendet nën autostradën Tetovë-Gostivar dhe do të ujitin sipërfaqe shtesë të tokës bujqësore të Komunës së Gostivarit, Vrapçishtit, Bogovinës, dhe Tetovës. Realizimi i këtij projekti do të mbulohet vetëm me mjete nga Buxheti i Maqedonisë përmes Programit për mbështetje financiare të zhvillimit rural. Këto projekte kapitale për sistemin e ujitjes nënkuptojnë më shumë siguri në sigurimin e sasisë së mjaftueshme dhe në kohë të ujit, përdorim modern dhe ekonomik të ujit që kontribuon në prodhim më të madh dhe rritjen e prodhimit bujqësor", tha kryeministri Zaev.

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, kërkoi nga ana e Qeverisë respektimin e afateve për realizimin e këtij projekti, me qëllim që, siç tha ai, në Pollog të prodhohet ajo sasi dhe

cilësi e produkteve bujqësore siç ka qenë në të kaluarën kur fusha e Pollogut ishte konkurrent kryesor me produkte në nivel Ballkanik dhe kishte një vend meritor.

"Unë do të doja që Pollogu përsëri siç ishte në të kaluarën - para tridhjetë vitesh konkurrent kryesorë gati në hapësirat Ballkanike me produktet e veta dhe zinte një vend të merituar. Me këtë vepër kapitale, uroj që sërisht t'i kthehet po asaj tradite që e ka pasur tash e 30 vite më parë. Zotëri kryeministër, kjo është një vepër që vërtetë na afron edhe me Evropën, sepse më afër Evropës jemi edhe me standarde, dhe ky është një standard që ne po e zbatojmë. Unë do të doja t'ju dëshiroj punë të mbarë juve si ekzekutiv, që këtu të mos ndalemi, por të vazhdojmë edhe më tutje, me vepra të rëndësishme dhe të pranishme për të gjithë qytetarët dhe sa më afër standardeve evropiane", tha Ahmeti. Ministri i Bujqësisë ndërkohë foli për

afatet e realizimit të këtij projekti.

"Ujitja është parakusht kryesor i bujqësisë dhe i ushqimit të mirë. Me këtë ndërtim do të zgjidhim problemin e ujitjes në Pollog, duke filluar nga pjesa e poshtme e Tetovës e deri në periferi të Malit Sharr. Përfshirë edhe lokacionet e Vrapçishtit, Gostivarit dhe Bogovinës. Projekti do të kushtojë 15 milionë euro të siguruara nga buxheti shtetëror, nga Programi për zhvillim rural në Maqedoni, ndërsa i gjithë projekti pritet të përfundojë për 60 muaj. Faza e parë do të zgjasë 6 muaj, ndërsa faza e dytë e realizimit duhet të fillojë vitin e ardhshëm", tha ministri Lupço Nikollovski. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, nënvizoi se ky është një ndër projektet më të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë në rajonin e Pollogut. Përndryshe, realizimi i plotë i këtij projekti pritet të zgjasë plot 60 muaj, kur edhe do të përfundojë dhe do të lëshohet në përdorim.

"ÇAGATAJ KABLO" NIS ME 300 PUNËSIME

TURQIT EDHE ME NJË FABRIKË NË BUNARXHNIK

Shkup, 31 gusht - Gjashtë milionë euro investim dhe punësim të rreth 300 personave duhet të jetë bilanci i fabrikës më të re turke në Maqedoni "Çatagaj Kablo" që dje edhe zyrtarisht filloi me punë. Bëhet fjalë për repart prej shtatë mijë metra katrorë, të vendosur në zonën industriale "Bunarxhik". Për ndërtimin e tij në fazën e parë janë investuar katër milionë euro dhe deri tani janë punësuar 80 persona. "Çatagaj Kablo" prodhon kablo për industrinë automobilistike dhe për mekanizëm bujqësor

dhe eksporton në korniza botërore.

"Ky është shembull se fjala e dhënë ka peshë, ndërsa premtimet e dhëna para qytetarëve plotësohen", tha drejtori i Drejtorisë së ZZHTI-së, Aleksandar Mladenov, para hapjes së repartit. Siç theksoi pronari i fabrikës Ahmet Koroglu, kompania ka vendosur të investojë në Maqedoni në vitin 2006, vitin e kaluar i ka vendosur themelet, ndërsa këtë vit fillon me prodhimtari. "Në fazën e dytë parashikojmë investimi të arrijë gja-

shtë milion euro, repartit të arrijë 10 mijë metra katror, ndërsa numri i të punësuarve të jetë 300", theksoi Koroglu. Sipas zëvendëskryeministrit Koço Angjushhev "Çatagaj Kablo" është fabrika e parë që hapet pas sjelljes së Ligjit të ri me të cilin barazohen kushtet për investimet e huaja dhe vendore.

Zëvendëskryeministri nënvizoi se kjo Qeveri në periudhën e fundit ka arritur të sjellë 16 kompani të huaja dhe të gjithë ata planifikojnë investime në vend. "Filli-

mi zyrtar me punë i "Çatagaj Kablo" për mua paraqet rezultat të politikave qeveritare stabile dhe të parashikueshme. Kjo Qeveri, në vend se me marrëveshje në katër sy, me Ligj e planifikon dhe realizon përkrahjen e investimeve të reja të huaja dhe vendore", tha ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi. Kompania turke "Çatagaj Kablo", mes të tjerash është e njohur edhe si furnizuese e prodhuesit belg të autobusëve "Van Hol" e cila tashmë është e pranishme në "Bunarxhik".

Për gjashtë muaj, 327 mln euro nga investimet e huaja

Shkup, 31 gusht - Investimet e huaja të drejtpërdrejta në gjashtë muajt e parë të këtij viti arritën 327 milionë euro apo 218 për qind më shumë se mesatarja në tre vitet e fundit. Kjo tregon se trendi i investimit në industrinë e Maqedonisë është përsheptuar, si dhe se politikat për mbështetje transparente të të gjitha kompanive absolutisht jep rezultat. Para numrave edhe zotërat heshtin, ndërsa numrat janë këta, i kumtuan edhe institucionet e shtetit, tha sot zëvendëskryeministri Koço Angjushhev.

Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Angjushhev theksoi se vetëm në tremujorin e dytë të këtij viti, kur zakonisht dividendët paraqiten, investimet e huaja janë sa përmbledhja nga investimet e huaja në tremujorët e dytë në tre vitet e fundit. "Edhe krahas asaj që disa kompani dividendët e veta i paraqesin, që është normale, ato shumë më tepër investuan në Maqedoni", shtoi zëvendëskryeministri.

Ai nuk tregoi nëse do të ketë ribalanc të Buxhetit dhe udhëzoi që këto pyetje t'i parashtrihen Minsitrisë së Financave. Ndërkaq, lidhur me realizimin e investimeve kapitale, theksoi se deri në fund të këtij viti pritet ato ta arrijnë nivelin e paraparë. Në pyetjen se si e komenton faktin se VMRO-DPMNE e ka sjellur investimin "Çatagaj Kablo" në Maqedoni, Angjushhev bëri thirrje që të ndërpritet PR-i i lirë dhe t'u mundësohet çka dëshirojnë, të punojnë.

"Në këtë pyetje mund të qeshem. Nuk mund të matim se kush kur për herë të aprë ka ateruar në aeroport, kush, kur, për herë të parë ka bërë takim, kush, kur, për herë të parë ka ardhur. E vërteta është se kompania bëri marrëveshje me Qeverinë tonë, se prej ditës së parë të ndërtimit të objektit unë isha i pranishëm këtu. Duhet të ndërprejmë të merremi me pyetje infantile dhe me PR të lirë. Unë një ditë nuk do të jem zëvendëskryeministër, a do të thotë kjo se të gjithë që kanë mbajtur takime me mua, duhet t'i paraqes si meritë timen në 10 vitet e fundit", tha Angjushhev.

Peticioni me nënshkrime i është dërguar Ministrisë së Mjedisit Jetësor, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Transportit si dhe Komunës së Tetovës, ndërsa kërkohet të merren masa për ndalesën e menjëhershme të punimeve të këtij projekti

BANORËT E VESHALLËS ME PETICION DREJTUAR INSTITUCIONEVE

KUNDËRSHTOHEM NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT



këtij fshati, thotë se ndërtimi i Hidrocentralit, do të dëmtojë biodiversitetin e këtij fshati pasi po ndryshohet rrjedha e natyrshme e lumit.

“Si ish banorë i këtij fshati, shpreh pakënaqësinë për këtë projekt që dëmton florën dhe faunën në këtë fshat. Ne nuk jemi kundër hidrocentraleve, por jemi kundër dëmtimit të natyrës sepse me ndryshimin e rrjedhës së lumit, shtrati do të mbetet një humnerë, ndërsa në të kaluarën aty ka patur tre mullinj që kanë funksionuar. Prandaj duhet që institucionet mos lejojnë këtë shkatërrim që ndodh”, tha Bexheti. Hidrocentrali, sipas Arjanit Xhaferi nga Lëvizja Eco Guerilla”, ndërtohet në një vend ku nuk ka ujë dhe uji sillet përmes gypave nga rrjedha e lumit të fshatit.

Ai kërkoi transparencë nga institucionet dhe nënvizoi se nëse nuk merren masa, do të ketë edhe

padi penale, sepse nuk është i lejuar me asnjë normë devijimi i rrjedhës natyrore të lumit. “Kërkojmë që institucionet që kanë dhënë leje, ti bëjnë transparente dhe ti publikojnë dokumentet. Është e ndaluar me ligj që të ndryshohet rrjedha e lumit, kurse e pakuptimtë është të ndërtohet hidrocentral ku nuk ka ujë. Një tentim i këtillë i filluar tani është ndaluar. Kjo duhet të ndodhë edhe këtu, të ndalen punimet”, tha Xhaferi. Sipas banorëve, punët i kryen investitori “Vodavat 6” në lumin e “Urës së Kollit”, lum ky që kalon në anën e djathtë të fshatit dhe pjesërisht përmes lagjes së quajtur “Mahalla Reke”. Peticioni me nënshkrime i është dërguar Ministrisë së Mjedisit Jetësor, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Transportit si dhe Komunës së Tetovës, ndërsa kërkohet të merren masa për ndalesën e menjëhershme të punimeve të këtij projekti.

“Projektin e konsiderojmë si jo të kompletuar me dokumente të nevojshme për leje pune, sepse deri më tani, fare nuk është njoftuar Bashkësia Lokale nga investitori, e as që është nënshkruar ndonjë dokument që do të shërbente si bazë për një marrëveshje, që do të parashihet dëmshpërblimin e pasurive private dhe favore tjera në interes të këtyre banorëve. Deviji-

mi i rrugës natyrore të lumit në fjalë në rrjedhën natyrore e ku dikur funksionin tre mullinj, drejt rajonit të quajtur ‘Për Bozovcë’, do të shkaktojë katastrofë të vërtetë ekologjike dhe dëme të paparashikueshme për kulturat bujqësore të tokave pranë këtij lumi”, tha Emin Denjalli, nga Bashkësia Lokale e këtij fshati. Në ndërkohë, profesori Vebi Bexheti, si ish banorë i

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 31 gusht - Banorët e fshatit Veshallë, kanë nisur një peticion me nënshkrime drejtuar disa ministrive dhe Komunës së Tetovës që të marrin masa për ndalimin e punëve për ndërtimin e hidrocentralit në këtë fshat. Të përkrahur edhe nga ana e Lëvizja “Eco Guerilla”, banorët janë shprehur të revoltuar, sepse nuk janë njoftuar për punët që janë kryer, ndërsa janë dëmtuar edhe prona private.

Publicitet



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të Vendimit për ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 02-15/III-16/2011 të datës 31.03.2011 dhe O. nr. 02-15/VIII -7/2014 të datës 31 korrik 2014, ndërsa në pajtim me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kushtet për zgjedhje të punimit më të mirë dhe ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 2927 të datës 13.04.2011, Rr nr. 7762 të datës 20.09.2012, Rr. nr. 28175 të datës 5 shtator 2014 dhe Rr. nr. 26412 të datës 30 korrik 2015, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë publikon

KONKURS PËR NDARJE TË ÇMIMIT VJETOR TË BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2019

Për shkak të stimulimit të zhvillimit të mendimit shkencor dhe përpunimit të punimeve nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare, si dhe afirmimit të kuadrove të reja dhe profesionale, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Banka popullore) ndanë Çmimin vjetor për hulumtues të rinj për punim më të mirë nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare.

Çmimi vjetor i Bankës popullore është 100.000,00 denarë, neto.

Të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë të moshës deri në 35 vjet. Punëtorët e Bankës popullore dhe anëtarët e Këshillit të Bankës popullore nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs.

Punimet parashtrihen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze. Punimi duhet patjetër të përmbajë edhe qasje ndaj ekonomisë së Maqedonisë në temën përkatëse. Punimi nuk duhet të kalojë 80.000 karaktere me vendet e zbrazëta (pa fusnotat, shtojcat, grafikonet, tabelat, abstraktin, bibliografinë, anekset) dhe është rekomanduese të ketë strukturë standarde të hulumtimit shkencor, i cili përmban pjesët themelore në vijim:

- abstrakt, si dhe theksim të sferës së hulumtimit sipas klasifikimit standard (Journal of Economic Literature - JEL);

- qasje ndaj literaturës së konsultuar nga sfera e cila hulumtohet;
- përshkrim të metodave të hulumtimit që shfrytëzohen në punim;
- analiza;
- pikëpamjet përfundimtare dhe bibliografia.

Një autor ka të drejtë të parashtrijë vetëm një punim.

Në Konkurs për zgjedhje të punimit më të mirë autorët kanë të drejtë të konkurrojnë edhe me punimet të cilat tash më janë publikuar, por jo para 1 janarit të vitit 2017. Gjatë parashtrimit të punimit, autori duhet të theksojë kur dhe ku është publikuar punimi.

Punimet parashtrihen deri në Bankën popullore me shenjë “Për Çmimin vjetor të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë”, përmes formës elektronike, në format “word”, në e-mail adresë: konkurs@nbpm.mk. Krahas punimit, autori duhet të parashtrijë edhe të dhëna biografike. Punimet e parashtruara do të kenë trajtim të materialeve me karakter të besueshëm.

Zgjedhjen e punimit më të mirë e bën Këshilli për vlerësim, i cili përbëhet nga tre persona, nga të cilët së paku njëri është person që nuk është i punësuar në Bankën popullore. Guvernatori i Bankës popullore emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit për vlerësim, me vendim i cili do të publikohet në internet faqen e Bankës popullore. Këshilli për vlerësim do të kryejë zgjedhjen e punimit më të mirë në mënyrë anonime, përmes vlerësimit të punimeve të futura në konkurrencën më të ngushtë sipas kriterëve në vijim:

1. Relevancë të fushës hulumtuese për rastin e Maqedonisë;
2. Përkatësi të qasjes së literaturës nga fusha e analizuar;
3. Qartësi në definimin e problemit dhe qëllimet e hulumtimit;
4. Përkatësi në përshkrimin e kontekstit dhe informacioneve (përkatësi të analizës së trendeve në fushën e analizuar në Maqedoni);
5. Përkatësi të qasjes së shfrytëzuar statistikore-ekonometrike;
6. Konzistencë dhe logjikë të tezave në punim;
7. Konkuzione dhe rekomandime dhe përkatësi të tyre.

Këshilli për vlerësim mund të ndajë çmim për punimin e dytë të shpërblyer në Konkurs në shumë prej 50.000,00 denarë, neto.

Afati përfundimtar për parashtrimin e punimeve është **1 shkurt 2019**.

Çmimi vjetor i Bankës popullore do të ndahet në evenimentin e organizuar me rastin e Ditës së pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 82/2018), nenit 34 paragrafi 1 të Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” (Fleta universitare nr. 274/13 – tekst i pastruar), Dekani i Fakultetit filozofik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, publikon

KONKURS

- 1) Për zgjedhje të një (1) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor shkencor nga sferat mësimore-shkencore: 50504 Metodika, 50521 Defektologjia, 50826 Kriminologjia, 50522 Mbrojtja dhe ndihma e të hendikepuarve, 50518 Pedagogjia sociale, për kohë prej 5 (pesë) vjet.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me nenin 164, nenin 165 dhe nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18), Statutin e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe Fakultetit filozofik në Shkup.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- biografi të shkurtër (CV),
- dëshmi për shkallën e arritur përkatëse të arsimit – doktor i shkencave,
- certifikatë të shtetësisë,
- deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës,
- dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, nga një kopje prej punimeve dhe formular të plotësuar Aneks 2 ndaj Raportit për zgjedhje në titujt të publikuar në ueb faqen e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” (Fleta universitare nr. 274/13 – tekst i pastruar).

Orari i punës së mësimdhënësit në titullin mësimor-shkencor është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit filozofik.

Bruto pagesa fillestare e mësimdhënësit është rreth 56.294,00 denarë.

Procedura e konkursit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor dhe bashkëpunues zgjatë më së shumti 6 muaj duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit.

Dokumentet parashtrihen në Fakultetin filozofik në Shkup, bul. Goce Dellçev nr. 9A, 1000 Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informata plotësuese mund të merren në numrin e telefonit 02 3116-520

Fakulteti filozofik në Shkup

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr +1 + Nën, trualli i parë në “Momin Potok” – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Kërkoj punëtorë për në Suedi të moshës 60 deri 65 vjeçare për kryerjen e punëve shtëpiake me mundësi për rregullimin e dokumenteve suedeze në bazë të kurorëzimit. Telefon për kontakt 0046760974613.

Të (mos) jesh Zijadin Sela Vragat e opozitarit me perspektivë

Nga
Daut DAUTI



Referendumi për emrin e ri Republika e Maqedonisë Veriore do të mbahet në ditën e fundit të shtatorit, partitë që e përkrahin marrëveshjen (kryesisht në pushtet) u takuan më 29 gusht, në të cilën nuk dëshirojnë të marrë pjesë Zijadin Sela, por Zijadin Sela dhe partia e tij, tri ditë më parë u prononcuan Pro, pavarësisht se në hartimin e Marrëveshjes me Greqinë kjo parti nuk ka marrë pjesë, e si opozitë shumëkush do të prishte prej saj të jetë Kundër. Por, ndoshta ky është thelbi i dallimit të një partie kryesore opozitare shqiptare nga një parti kryesore maqedonase (VMRO-DPMNE). Dallimi, pra, qëndron në qëndrimin ndaj interesave strategjike të vendit, ku të qenit opozitë nuk do të thotë të qenit kundër projekteve të cilat i shtyn dikush tjetër, dikush në pozitë e pushtetit ku nuk merr pjesë. Po i njëjtë është edhe qëndrimi ndaj ligjit për përdorimin e gjuhës, edhe pse doli nga Qeveria, deri në fund mbeti ta përkrahte, pasi ishte projekt që kishte nisur që nga koha kur Aleanca ishte pjesë e qeverisë.

Pra, në bllokun politik shqiptar kemi një rast tipik i asaj që e quajmë "opozitë konstruktive", çfarë më tepër se kurrë i nevojitet bllokut politik maqedonas, ku assesit të rreshtohet VMRO-ja e Mickovskit.

Koha është një kategori relative, shpejtësia, ngadalësimi, vendnumërimi... Mund të kalojnë vite, dekada e shekuj dhe të mos ndodhë asgjë (për një popull, shtet...), e ndonjëherë të kalojë një vit a dy dhe të ndodhin aq shumë gjëra dramatike, me ngritje, rënie, kthesa e të papritura... Ndoshta kësaj mund të mendojë edhe Zijadin Sela, duke bërë rikapitullimin e këtyre dy viteve të fundit. Ku ishte dje, ku është sot, por dhe më tepër, ku do



Ai sot është me vragat e 27 prillit, por dhe me ato të zgjedhjeve lokale të 4 qershorit 2017, kur Aleanca hapi derën (vetë) ose ia hapën (Zaevi, BDI) për dalje nga Qeveria. Në situatën e tashme, Sela vazhdon ta luajë rolin e një opozite konstruktive, sa kritik ndaj veprimeve të qeverisë, aq dhe bashkërendues në çështjet strategjike, që atij i siguron një pozicion për rezultate pozitive në zgjedhjet e ardhshme

te gjendet nesër... Padyshim, si përfundim i gjithë këtyre zikzakeve do të jetë një hap para në karrierën politike, pavarësisht se sot nuk është atje ku ishte para një viti (në qeveri), sepse nuk matet suksesi i një subjekti vetëm me hyrje në qeveri, por me rolin që luan në përgjithësi në jetën politike. Me një analogji që bëra në shkrimin për liderët e Lëvizjes Besa, të dikurshmin dhe të tashmin dhe për strategjinë e kësaj partie, mund të themi se Aleanca sot është në pozitë të ngjashme si Lëvizja Besa para një viti, jashtë qeverie por me përkrahje të disa proceseve që ajo i shtyn, ndonëse ky pozicion nuk ka qenë ai që ka synuar lideri i saj.

Kur bëhej kjo qeveri, Zijadin Sela dhe partia (koalicioni) që i printe kishin një qëndrim të qartë: për të hyrë. Ishte pjesë e një koalicioni anti-VMRO-ist dhe largimi i asaj partie ishte objektivi kryesor. Pastaj ishte diçka më e madhe se kjo: ishin krijuar rrethana për disa lëvizje pozitive në

avancimin e pozitës së shqiptarëve, prandaj do të japë kontributin për deklaratën e përbashkët të partive shqiptare ("Platforma e Tiranës"), duke u pajtuar me fatin se në hartën e re politike ndër shqiptarët, partia e tij ishte bërë faktor i tretë (e kishte shtyrë madje dhe partinë amë, PDSH-në), porse nuk kishte arritur të bëhet e dyta (ku ishte pozicionuar rivalja Lëvizja Besa). Kjo e shtyri Zijadin Selën që "t'ia delegojë" Ali Ahmetit qëndrimet e koalicionit të Aleancës për Shqiptarët (LR-PDSH + RDK-krahu i Vesel Memetit) në bisedimet për krijimin e Qeverisë, si një shprehje realizmi dhe pragmatizmi. Në të njëjtën kohë, Lëvizja Besa deklaronte përkrahje të qeverisë së ardhshme, por pa pjesëmarrje në të. Por sot është pozicionim paksa i imponuar nga disa rrethana të papritura, në të cilat u gjet kjo parti. Shumëkush këtë e quan pozicion të "viktimit të pamërituar". Viktimë vetë partia, por dhe më tepër, lideri i saj, Zijadin Sela, i cili në 27 marsin dramatik në Kuvendin e Maqedonisë, shpëtoi për pak nga ekstremistët maqedonas, të cilët e kishin kërkuar pikërisht kokën e tij. Ai sot është me vragat e 27 prillit, por dhe me ato të zgjedhjeve lokale të 4 qershorit 2017, kur Aleanca hapi derën (vetë) ose ia hapën (Zaevi, BDI) për dalje nga Qeveria. E ardhmja do të tregojë nëse lëvizjet që bëri Zijadin Sela në rrethin e dytë do t'i sjellin dobi afatgjate. Në afat të shkurtër, gjërat dihen: në rrethin e dytë Zijadin Sela, si lider i një partie në pushtet bëri pakt me Bilal Kasamin opozitar, kundër dy partive të tjera (BDI, LSDM) me të cilat ishte në koalicion.

Kur të thyhet qerrja hapen shumë rrugë. Tash kur shumëkush e quan pozitën e Aleancës dhe fajin e kërkon te të tjerët, gjërat duhet

shikuar në tërësinë e kontekstit. Zgjedhjet lokale u treguan si një rreshtim dhe keq për disa parti, ku partia e Selës forcoi pozitën por humbës doli Sela. Vetëm ai dhe ata me të cilët ka bërë përpjekje për pjesëmarrje të përbashkët në zgjedhje e dinë a ka pasur mundësi për kombinime tjera. Fakti që dihet botërisht është se as bashkëpunimi në rreth të dytë me Lëvizjen Besa nuk i ndihmoi ta mbante Strugën, ku e koalicioni kishin bërë "peshqit e mëdhenj", Zaevi e Ahmeti, por me një koalicion të deklaruar parazgjedhor, ku vendimtare ishte abstinenca e LSDM-së nga Kërçova e Çairi dhe ndihma e drejtpërdrejtë në reth të dytë në Strugë, por e pamjaftueshme në Gostivar. Publiku nuk i di të gjitha prapaskanat, dhe nuk po përpiqem as unë të hyj aty, por për një parti në pushtet do të ishte shumë më e logjikshme që të gjendej ndonjë formulë bashkëpunimi midis LSDM-së, BDI-së dhe LR-PDSH-së, kështu që fitorja në tri komuna në koalicionin me Lëvizjen Besa opozitare për rreth të dytë, ishte fitore e Piro, sepse ajo e pozicionoi para Lëvizjes Besa (me një komunë të fortë si Gostivari dhe dy të tjera, kundrejt një komune rurale të Besës), por përfundimisht prishi idilën me BDI-në, e cila nuk mund t'ia falte Gostivarin që kaloi në duart e Taravarit, ministrit të popullarizuar të shëndetësisë, humbjen e të cilit e prishte Zaevi për ta kthyer sërish ministër. Politika ka aspektet e pragmatizmit dhe shpesh duket si fushë gladiatorësh, ku objektivi i mbijetesës të çon në veprime që të shkelësh madje dhe parimet për të cilat ke luftuar. Si bie fjala, koalicionet me ata që dje keni hedhur gurë e dru mes veti. Si në fushë shahu, flijon mbretëreshë për një këmbësorë, ose anasjelltas! Fi-

ton tri komuna dhe humb pushtetin qendror...

Sot të jesh Zijadin Sela është më mirë se të jesh Afrim Gashi, Bilal Kasami ose madje dhe Menduh Thaçi. Flasi për një të ardhme politike. Pas përçarjes së Lëvizjes Besa, shumëkush opozitë të vetme dhe më të fortë se tash e sheh Aleancën për Shqiptarët. Kur e nisi betejën për "reformën" e PDSH-së, sigurisht as vetë Sela nuk e ka pritur që subjekti i tij do të dilte më i fortë se partia amë, e cila vështirë se do ta marrë veten edhe pas hyrjes në Qeveri. Elektorati tradicional i PDSH-së, përveç nostalgjikëve "të kohërave të vjetra", u përcaktuan për Selën kundrejt Thaçit (të cilit do t'i merret si handicap i madh ajo biseda e famshme me Mijallkovin nga përgjimet). Sela luajti rol vendimtar për zbritjen e Grueskut nga pushteti me hyrjen në Qeveri, kurse te një numër i madh shqiptarësh ai ishte viktima dhe heroi i 27 prillit, të cilin vetëm fati e shpëtoi nga më e keqja. Në sytë e shqiptarëve mbetet si fakt që Sela kishte qenë cak sulmi si një "mbrojtës i kauzës shqiptare", prandaj dhe dalja e më vonshme nga qeveria merret si një rrjedhojë e pamerituar. Në situatën e tashme, Sela vazhdon ta luajë rolin e një opozite konstruktive, sa kritik ndaj veprimeve të qeverisë, aq dhe bashkërendues në çështjet strategjike, që atij i siguron një pozicion për rezultate pozitive në zgjedhjet e ardhshme. Është pak e besueshme se këtë pozicion mund t'ia rrezikonte kambeku i Thaçit në një qeveri "SDMS-iste", sepse është dëshmuar nga fati i PPD-së se kur një herë të ikë treni (i historisë), zorse mund ta zësh përsëri.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goe Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 31 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Tryeza politike shqiptare



Nga
Dr. Arben TARAVARI

Për Maqedoninë e cila është vendosur para dyerve të NATO-s është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm ky i tanishmi. Si rrallë herë projektorët ndërkombëtarë janë kthyer kah ne. Është një moment ankthi politik, diplomatik, social, ekonomik, pasi ajo derë që pret të hapet ndryshon shumë gjëra jo vetëm për ne që jetojmë në Maqedoni po edhe për fqinjët tanë, por edhe për miqtë e afërt dhe të largët. Pritet që ne të trokasim ashtu si do Evropa dhe SHBA-të, dhe dera atlantike veriore hapet. Të trokasësh sipas ritmit të diktuar nga miqtë tanë ndërkombëtarë, do të thotë votim i referendimit të 30 shtatorit, do të thotë ndryshim i emrit të shtetit, do të thotë edhe fillim i integriteteve dhe reformave, fjalë të cilat si emra i kanë përdorur shumë politikanë në Maqedoni por kurrë nuk i arritën! Opinioni politik i përfaqësuar nga politikanë, opinionistë, gazetarë e njerëz me një lloj impakti social, kanë dilemat e veta!

Ka fanatikë-fundamentalistë të cilët edhe pse në kufijtë e një jete të botës së tretë, preferojnë të rrezikojnë rrënim ekonomik dhe emri mos të ndryshojë asses! Ka politikanë të cilët këndojnë këngë

Hartimi i një plani të përbashkët për të mirën e të gjithë atyre që jetojnë në Maqedoni është nevojë urgjente e momentit. Ne, shqiptarët, veçanërisht dhe fatkeqësisht dimë të shohim njëri-tjetrin më shumë si problem se sa si zgjidhje. Është kjo psikozë e pasqarueshme që ka ditur të na sjellë pasoja të rënda ndër shekuj...



të tjera nga ato të djeshmet, vetëm sepse janë ulur në kolltuqe qeveritare që po ju shijojnë shumë, shpresoj që rehatia e rrejshme e kolltukut mos t'i verbojë deri në pika

të pakthyeshme. Ka nga ata të cilët vetëm flasin dhe nuk mendojnë. Ka nga ata të cilët e duan me gjithë zemër përparimin e popujve të Maqedonisë si një shtet që jeton në harmoni dhe barazi. Ka të bindur dhe ka prej atyre që dyshojnë. Krahu më pak dyshues për ndryshimin e emrit janë shqiptarët dhe të gjithë maqedonasit të cilët nuk duan të jenë më kukulla të një politike kriminele.

Të gjithë ne bashkë duam ta marrim këtë shtet për dore dhe ta çojmë aty ku përkasim, në Evropën mike. Na duhet unitet më shumë se kurrë, sidomos faktorit shqiptar, ndaj në cilësinë e një fuqie politike si që është Aleanca për Shqiptarët, bëjmë thirrje për një tryezë të përbashkët politike shqiptare. Tryezë për të cilën u zbutuam të gjithë, duke e firmosur Deklaratën e Partive politike parlamentare shqiptare, në janar të 2017. Kjo tryezë e specifikuar shqiptare, nuk ka për qëllim diskriminimin e asnjë etnie që jeton në shtetin tonë. Ka për qëllim të vetëm, mbrojtjen e interesave të shqiptarëve të bazuar në liritë e individit dhe liritë e demokracisë. Duke arritur një marrëveshje solide brenda krahut shqiptar do të jemi ende më gati për të bashkëpunuar me çdo grup tjetër politik,

etnik, diplomatik, miqësor apo strategjik. Hartimi i një plani të përbashkët për të mirën e të gjithë atyre që jetojnë në Maqedoni është nevojë urgjente e momentit. Ne, shqiptarët, veçanërisht dhe fatkeqësisht dimë të shohim njëri-tjetrin më shumë si problem se sa si zgjidhje. Është kjo psikozë e pasqarueshme që ka ditur të na sjellë pasoja të rënda ndër shekuj. Nga ana tjetër, po ne shqiptarët kemi treguar në histori që jemi pjesë e arkitektëve të qytetërimit të vjetër evropian. Flamuri ynë nuk ka shkelur kurrë një tokë të huaj si pushtues. Kemi qenë gjithnjë të paqtë e kemi respektuar mikun si veten. Nuk kemi parë asnjë ngjyrë, fëmijë apo zakon tjetër si problematik, madje i kemi respektuar maksimalisht. Kemi dashur dhe e duam ende më shumë zhvillimin e arsimit sepse dija është liri, është harmoni, është paqe. Edhe pse viktimë të një politike fashiste, deri në kohët moderne na është mohuar e drejta e shkollimit në vendin tonë, në gjuhën tonë, ne ende kemi motiv paqen dhe bashkëpunimin ndëretnik për të arritur qëllimet tona.

Me ndryshimin e sistemit, menjëherë prindërit shqiptarë vrapuan të shkollojnë fëmijët e tyre. Ky është shembulli më i qartë

i llojit të luftës tonë, luftës për dituri. Megjithëse është abuzuar shumë nga vet shqiptarët e nga të tjerë, e ardhmja jonë duhet dhe do të jetë EVROPIANE! Por kushti kryesor që kemi para derës është: të ulemi këmbëkryq me njëri-tjetrin, si shqiptarë, të shohim njëri-tjetrin si familje, në mënyrë që të jemi pjesë e një Familje edhe më të madhe. Jemi të sigurt që në zemrën e çdo shqiptari fle ëndrra e paqes dhe e zhvillimit. Dita kur të gjithë ne mund të jetojmë si etni dinjitoze brenda një shteti të vetëm nuk është larg. Regjimet e frikshme, ata që na kanë vënë të qajmë fëmijë të pafajshëm, që na kanë detyruar të nisim rininë jashtë në mërgim, që nuk na kanë dhënë të drejta normale të barabarta me çdo popull tjetër, nuk kanë përfaqësuar asnjëherë popullin, por vetëm disa individë që me forcë, dhunë e plane antinjerëzore - kanë plagosur demokracinë e vendit dhe kanë tentuar të egërsojnë popullin shqiptar. Gjithsesi fisnikëria është në ADN-në tonë, ndaj duhet dhe do vazhdojmë të besojmë tek dialogu, duke u bashkuar dhe kërkuar zgjidhje dinjitoze për shqiptarët në Maqedoni.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Po femra, ku na mbeti?



Nga
Delvina KËRLUKU

Përgruan në shoqëri është folur shpesh dhe gjerësisht. Është folur dhe shkruar sidomos për pozitën e femrës shqiptare në shoqërinë tonë specifike. Themi specifike, meqë të tillë e ka pasur traditën dhe trashëgiminë: pa nivel arsimor të mjaftueshëm, me shkallë emancipimi të paktë, pa mbështetje pushteti, por edhe pa mbështetje të mjaftueshme të familjes, si pasojë e mendësisë provinciale dhe edukimit patriarkal. Mu për këto arsye që përmendëm, por edhe për shumë të tjera, femrës sonë i është dashur të bëjë një luftë titanike për të siguruar një pozitë sidoqoftë në shoqëritë dhe mjediset ku ka jetuar dhe vepruar.

Është dashur t'i shkatërrojë barrierat e paragjykimet e ndryshme. Nuk mendoj se me një shkrim të këtillë do të arrij të përshkruaj gjendjen e gjysmës së njerëzisë. As ta ndryshojë pozitën e saj në

mënyrë thelbësore. Vetëm desha të ndaj një shqetësim me lexuesin e nderuar, duke konstatuar se jemi larg së qenit të barabartë, dhe se dukuri të shëmtuara dhe sjellje barbare karshi femrës, hasim edhe në shekullin XXI, pra në ditët tona. Pra, dua të them dy - tre fjalë rreth gjendjes së grave, e veçanërisht të femrave shqiptare. Natyrisht që reformat e shpeshta në sfera të ndryshme të veprimtarisë shoqërore kanë ndikuar në ndryshimin dhe përparimin e pozitës së saj, por këto ndryshime janë të pakta e të vakëta dhe nuk mundësojnë zhvillim më të hovshëm të femrës sonë. Ajo ka nevojë për ndërmarrje rrënjësore. Për gjithë këto vite nuk është konsoliduar ndonjë brez femrash, që do të identifikoheshin me ndonjë arritje të shënuar në fushën e arsimit, shkencës, politikës, sipërmarrësisë. Edhe pse kemi një numër jo të papërfill-

shëm femrash në fushën e artit dhe kulturës, si në muzikë, letërsi art figurativë etj., megjithatë ato janë ende nën hijen e emrave mashkullorë, jo rrallë ndodh që të nëpërkëmben dhe nënçmohen vlerat e tyre, edhe pse i tejkalojnë vlerat, të themi artistike, të kolegëve meshkuj. Qëllon që ajo të mos merret seriozisht gjatë vlerësimit, përzgjedhjes, ftesës për pjesëmarrje në evente të ndryshme. Ajo paragjykohet dhe shpesh ndodh që organizatorët t'a ftojnë për ta zbuluar ambientin, ose edhe për motive akoma më banale dhe ofenduese.

Pra, ajo edhe në këto raste duhet të luftojë e dëshmojë vlera që i ka krijuar me aq mund e sakrificë, dhe jo stolitë që ia ka falur Zoti. Duke u mbështetur nga gjithë kjo që thamë më lart, mund të vijmë në përfundim se femra shqiptare në Maqedoni, akoma është


e rrezikuar dhe nuk është ajo që rrezikon statusin dhe pozitën e mashkullit. Për të ardhur keq!

Kur po flasim për këtë temë, nuk mund t'i shmangemi një pyetjeje fare të thjeshtë: Pse mashkulli në këtë rast kënaqet me rolin e vëzhguesit pasiv? Nuk duam të themi: pse mashkulli bëhet pengesë e përparimit të femrës, e cila mund të jetë bija e tij, motra e tij, bashkëshortja e tij, kushërira e afërt apo e largët e tij? Përse nuk e do të barabartë, apo vetëm për të kënaqur sedrën e tij të sëmurë, se na qenka i lindur superior nga vetë Zoti?! Si nuk e kupton se pozita e mjerë e gjysmës së shoqërisë, është mjerim i tij dhe i gjithë shoqërisë?! Si nuk e kupton se ngecja e femrës, është ngecja e mbarë shoqërisë. Si nuk e kupton ai se "Dora që përkund djepin, është dora që përkund botën". Deri kur shqiptari ynë do kënaqet me Dijen të Haki

Stërmillit te romani Sikur t'isha djalë?! Koha ecën edhe pa femrën e barabartë, por ecën shumë ngadalë, e pasojat i vuajmë të gjithë. Pse harrojmë faktin se shtylla e familjes është femra. Prandaj duhet luftuar të gjithë që kjo shtyllë të jetë e fortë - pra e arsimuar, e edukuar! Ajo kultivon brezin e ardhmërisë së shtetit, të kombit! Femrës sonë, në shumicën e rasteve, jo që nuk i ndihmohet, por ajo pengohet në mënyrat më të shëmtuara.

Asaj i kërcehen me të gjitha mjetet e mundshme të dhunës, deri te tentimi ose vetë përdhunimi, që për botën e emancipuar i tejkalon kufijtë e kriminit. Dhe kjo dukuri është aq prezentë, sa e has si lajm të rëndomtë e të shpeshtë në mjetet e informimit të përditshëm. Kjo që publikohet, por rastet që heshten? Nuk dua të zgjatem se kjo është temë më vete, bashkë me neglizhencën e organeve kompetente.

FJALËKRYQI KLASIK





HORIZONTALISHT: 3. Monedha shqiptare; 5. Art (frëngj.); 7. Tërkuzë; 9. Markë italiane kamionash; 10. Autori ynë, Kukaj; 12. Kryeqyteti ynë; 13. Që nuk mund të folë; 15. Uji i ngrirë; 16. Aktori amerikan, Rivs; 18. I përhimët; 20. Veshje e sipërme burrash, nga leshi i deles; 23. Kafshë me brirë të degëzuar; 24. Jo profesionisti; 26. Këngëtarja amerikane, Pat; 28. Ceremoni; 30. Dajre; 31. Kryeqyteti i Ukrainës; 33. Këngëtari ynë i muzikës tallava; 41. Automjet mbartës; 42. Lloj problemi enigmatik; 43. Dru pylli i lartë; 44. Pjesë të caktuara kohe për ndonjë veprimtari; 47. Lloj druri për ndërtim të anijeve; 48. Shprehje pabesie për diçka; 49. Rajon historik në Greqi (pashq.).

VERTIKALISHT: 1. Bonjak; 2. Mjet për të zënë peshk; 3. "Mbreti" i Shekspirit; 4. Pije e nxehtë; 5. Gaz që formohet gjatë vlimit; 6. Sport i dimrit; 8. Memorja e kompjuterit; 9. Shkoi, vajti; 11. Autori ynë, Dervishi; 12. Një muaj viti; 14. Numri 101 romak; 15. Botim i përvitshëm, vjetar; **17. Këngëtarja jonë në foto;** 18. Banor i një shteti fqinj; 19. Markë franceze veturash; 21. Cipë e jashtme e fortë; 22. Vokali i "Elitës 5", Ziberi; 23. Decibeli; 24. Një yjësi; 27. Ish portieri spanjoll, Luis; 30. Monedhë e Marokut dhe e Emirateve (sh. pashq.); 32. Victoria University; 33. Pyll; 34. Aktivisti shqiptar, Duraku; 35. Filloj; 36. Toronto; 37. Përemër vetor; 38. Aktorja kroate, Rina; 39. Miku, Jarani; 40. Jo i moshuar; 45. Pjesa e qafës; gryka; 46. Markë e Daevusë.

Kakuro

5x5 dhe 6x6


Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudoku. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të





DOMINOJA

Plotësoni fjalëkryqin duke i bartur katrorët e dhëna më poshtë. Në fushat e hijezuara do të fitoni emrin e përrallës në fotografi.



A	S	I	A	U	T	SH	T	E			
I	Z	A	L	O	D	S	A	M	U	A	R
R	I	M	A	T	A	A	R	U	K	S	I


R	T	A	K	A	DH	Ë	M	A	M	E	R
I	R	R	K	I	K	U	M	I	P	O	
LL	I	O	R	N	A	I	K				

T	R	A	K	O	N
T	I	M	A	M	E
SH	P	K	A	R	


M	A	R	S	O	R
M	E	A	N	A	
SH	B	B	A	N	

Ç	E	O	A		
LL	O	T	A		
T	O	L	I	N	G

J	A	E	V	I
A	V	A	R	T
N	D	E	S	I



Fshehësira



DEKODIMI

Lidhni pikat e zeza, duke filluar nga katrori i vogël dhe përfundoni te rrethi. Në fushat e pikave të zeza duhet të zgjidhni njërën nga katër shkronjat e dhëna dhe të vazhdoni në fushën tjetër.

Në fund, lexuar me radhë do të fitoni poezinë e Naim Frashërit:

"_____ sa e mirë!

Sa e ëmbël, sa e gjerë!

Sa e lehtë, sa e lirë!

Sa e bukur, sa e vlerë!"

ABCÇ •	DDhEË •	FGGjH ■
IJKL •	LIMNNj •	OPQR •
RrSShT •	ThUVX •	XhYZZh •

Zgjidhja: _____


Mini KENKEN

Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

6 ×	9 ×	
		5 +

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

1-	48x	2+		6+	1-
			180x		
12x				2+	1-
8+					
3+	50x			2+	5-
		2-			

ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!

	3			2			7
	1		10		8		6
				9			7
		8					6
		5			4		
	5	3				2	
							9
1			10	4			

NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.

	2		1		1		
	1	3	1	3	2		
1	1						
2	1						
2	2						
1	2						
1	1						



mini SKANDI me anagrame

Anagramet e mëposhtme ju japin dy vepra të autores dhe gazetares në foto.

Anagrami 1

PËRDOR
FUSTANË!
(R=D)

Anagrami 2

A KA N'RUSI?

Mensur Mamuti	AUTORJA DHE GAZETARJA NË FOTO	FUTBOLLISTI KILIAN MAURICIO ENË PËR TË ZIER ÇAJ	I	LIMAN NË AFRIKËN JUGORE	SHTET I LASHËTË NË MESOPOTAMI
FATI, KËSMETI					
PERSON QË E ZEVENDESON AKTORIN NË SKENAT E RRËZIKSHME					
D					
POLITIKANI FRENÇ, ZHYLJEN					ANAGRAMI 1 (VEPËR E AUTORËS NË FOTO)
DY ROMAK RAJON NË ETIOPI			POSTË -TELEFON	EOREM BASHA	
KOHA E LIRË	JO AKTIV	SONDAZHI VENDET ME ULLI			
QYTET NË SHQIPËRI				AKTORI ITALIAN, SPENSER PUNJES ARASH	
PËLHURË E NDRITSHME PAMBUKU ME LULE NGJYRASH TË NDRYSHME				ZANORE TË NJËJTA AI QË BËN NË ATENTAT	
ANAGRAMI 2 (VEPËR E AUTORËS NË FOTO)					
BAZENET					
P					FOSFORI VANADI
VANGJEL TOÇE		NDERPRITJA E PUNËS NGA MOSKENA QËSIA QYTET NË TIMORIN LINDOR			
AUTORE SHQIPTARE	HYJESHË HITITE ARGONI			SHEGË NJERIU I PARË, ADEMI	
KALI I SHALES			ASTATI SHOK (FRËNGJ.)		SUEDIA INTERNET EXPLORER
RUMANIA		LLOJ EMBËLSIRE TRIM, BUJAR			
KOHA E LIRË	FUTBOLLISTI ITALIAN, LUKA MAGEDONIA				
KËNGËTARI KROAT, SAVIQ					AZOTI INTENSITETI
MARKË KOREANE AUTOMJETESH				ELEMENT KIMIK (R)	

Sudoku

i lehtë

4		7	8	3	
	3	9			
1	8	6		3	
6	7	9		8	1
2	1		8	3	6
		5		8	2
9			2	7	
		6	4	5	9

mesatar

1	9			7		4
5			9			
	8	3				
		4		7	9	3
	2					8
		9	5	6	7	
					1	6
			1			8
2				8	9	5

i vështirë

				5		
		1	4			8
2	9					6
1	7		2			
6			3	7		
	3	8				
				4	8	
	4				3	1
	2	7	8			9

5		9	8	7		3
		4		6		
	6		1		4	
1	8				7	6
6	7			9		2
9	4				3	1
	5		3			6
		5	2			
8		7	6	9		4

7	3	8	2	6	4
5					8
	1	5	9		
3	8	6	5		
		1	3	7	9
	8	1	4		
9					1
1	5	2	9	3	7

3	4				
		4	5	7	
				1	8
			3	9	8
		6	1		
1		8			2
	6		4	9	
9	8	6	7	3	
3					

ARITMOGRIFI

Përgjigjet i shënoni në rrjetin me numra (mbi foto). Pastaj, sipas rregullit **“numri i njëjtë - shkronja e njëjtë”**, shkronjat e fituara bartni në tabelën tjetër (nën foto). Me plotësimin e drejtë të tabelës do të fitoni grupin shkupjan (në foto), emrat e anëtarëve si dhe një hit të tyre.

VERTIKALISHT:

- Lloj sheqerke
- Ithtari i budizmit
- Shtrat i ulët, prej dërrasash, nim
- Llogaritja
- Rreth me trajtë vezake (shq.)
- Mëkati
- Komunitet fetar, me origjinë kristiano-protestante e batiste, të themeluar në Zvicër në shek. XV
- Një shenjë pikësimi
- Ish futbollisti gjerman, Zeler
- Lojtar mbrojtës në futboll
- Pjesë e tenisit
- Dhënia pëlqimit për një punë, miratimi
- Aktorja italiane, Ana
- Veshja, që vishet zakonisht mbi këmbishë
- Dreqi
- Urdhëresë që duhet të zbatohet
- Kalaja.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1	9	16	23	30	36	42	46	50	53	56	60	66	72	78	85	92	
2	10	17	24	31	37	43	47	51	54	57	61	67	73	79	86	93	
3	11	18	25	32	38	44	48	52	55	58	62	68	74	80	87	94	
4	12	19	26	33	39	45	49				59	63	69	75	81	88	95
5	13	20	27	34	40						64	70	76	82	89	96	
6	14	21	28	35	41						65	71	77	83	90	97	
7	15	22	29											84	91	98	
8																	99

Legjendat e muzikës shqipe



	95	75	31	57	55	26		13	24	80	49	81	62	69	48	41	33	89		45	46	86	18	88	99	25
43	97	76	12		52	38	51	20	21	9	10	68	2	92	50		65	34	5	61	14	94	4	40	91	83
27		71	19	73	85	54	3	72	8	64	67	17	7	84		37	98	22	59	56	28	82	29	60	15	
53	6	74	44	16	42	96	11	32	70	47		58	39	36	79	87	66	77	90	63	23	93	78	30	35	1

NGJIDHJET

FSHËHËSIRA

NONOGRAMI

KENKENI

DOMINIONA

SUDOKU

ARUKONË

SUDOKU >“

KAKURO

DEKODIMI

ARITMOGRIFI

Legjendat e muzikës shqipe

me anagramet

SKANDI

RAVLEKRYQI KLASIK

Presidenti Thaçi ka vazhduar të mbështesë idenë e proklamuar që marrëveshja paqësore me Serbinë të përfshijë edhe korrigjimin e kufirit. Ai ka deklaruar se marrëveshja nuk do të përfshijë "ndarje dhe as shkëmbim të territorit me Serbinë", por sipas tij, mund të bëhet një korrigjim duke përfshirë brenda territorit të Kosovës Komunitat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë

Disa ditë para takimit të radhës me homologun e tij serb, Aleksandar Vuçiq, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka takuar krerët institucionale të Kosovës. Në zyrën e tij, kanë qenë kreu i Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe tre zëvendëskryeministrat Behgjet Pacolli, Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi. Aty u diskutua për dialogun, derisa mungonin përfaqësuesit e opozitës.

Presidenti Thaçi ka vazhduar të mbështesë idenë e proklamuar që marrëveshja paqësore me Serbinë të përfshijë edhe korrigjimin e kufirit. Ai ka deklaruar se marrëveshja nuk do të përfshijë "ndarje dhe as shkëmbim të territorit me Serbinë", por sipas tij, mund të bëhet një korrigjim duke përfshirë brenda territorit të Kosovës Komunitat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. "Asnjë marrëveshje nuk do të ndodhë nga ana e Kosovës pa pël-

THAÇI NUK HEQ DORË NGA KORRIGJIMI I KUFIRIT



qimin e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Kushdo që del kundër, e kanë gabim", tha Thaçi. Këto komente, ai i bëri pas marshit të organizuar në Ditën Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur dhe dy takimeve që kishte zhvilluar me liderët politik vendorë si dhe një telefonate që kishte zhvilluar me ndihmësekretarin amerikan të Shtetit për çështje evropiane dhe euroaziatike, Wess Mitchell. Çdo marrëveshje eventuale me Serbinë, nënvizoi Thaçi do të dërgohet në Kuvendin e Kosovës për ratifikim.

Paraprakisht, pas takimit të liderëve politikë, kryeministri i Ko-

sovës Ramush Haradinaj tha se në dialogun me Serbinë nuk mund të bisedohet për territorin dhe kufijtë e Kosovës dhe një gjë të tillë, kreu i Qeverisë tha se ia kanë bërë të qartë edhe presidentit Thaçi. "Kishim një konsultë mes institucioneve, ishte presidenti, ishte kryeparlamentari, ishin zëvendëskryeministrat Limaj dhe Gashi. Në përgjithësi, konsulta ishte rreth dialogut, proceseve në dialog. Nuk kemi biseduar për mënyrën e shkuarjes, kryesisht për parimet e dialogut, pra që dialogu është i nevojshëm, është i rëndësishëm, njohja reciproke është e nevojshme. Procesi i dialogut nuk nënkupton diskutim të territorit,

as të kufijve të Kosovës", tha Haradinaj.

Sipas tij, edhe presidenti Hashim Thaçi është shprehur kundër ndarjes së Kosovës dhe diskutimit të integritetit territorial të Kosovës në bisedimet në Bruksel. Haradinaj tha po ashtu se roli i opozitës në procesin e dialogut është shumë i rëndësishëm. "Presidenti shprehu pozicionin e tij se respektin jo vetëm territorin, integritetin, sovranitetin e vendit, por vetëm i ushtron funksionet e veta në bazë të Kushtetutës dhe nuk pranon të diskutohet territori i vendit. Ajo që mendoj që është shumë me rëndësi është që të kemi qëndrim të qartë institucional se terri-

tori, kufijtë nuk diskutohen, nuk janë çështje për diskutim në kuadër të dialogut. Pastaj, është shumë me rëndësi që opozita, të gjithë të jenë pjesë e dialogut", tha kryeministri Haradinaj.

Takimi i radhës në Bruksel, mes presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologut të tij serb, Aleksandar Vuçiq është paraparë të zhvillohet më 7 shtator, në kuadër të dialogut mes dy shteteve që ndërmjetësohet nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Bazuar në deklaratat e dy presidentëve në Forumin Evropian të mbajtur në Alpbach të Austrisë gjatë fundjavës, korrigjimi i kufirit do të jetë pjesa kryesore e marrëveshjes që Thaçi e Vuçiq synojnë të arrijnë. Mirëpo, partitë opozitare në Kosovë, janë duke tentuar që të ndalojnë presidentin Thaçi që të takohet sërish me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrahur edhe nga partitë tjera opozitare, kanë paralajmëruar seancë të jashtëzakonshme më 4 shtator, tri ditë para takimit të dy presidentëve. Në këtë seancë, ata kanë paralajmëruar se do të nxjerrin një rezolutë, përmes së cilës do të mund ta ndalojnë presidentin Hashim Thaçi që të vazhdojë dialogun me Vuçiqin. Kjo kërkesë për seancë të jashtëzakonshme është quajtur absurde nga kreu i Kuvendit Kadri Veseli. Derisa partnerët e PDK-së në koalicionin qeverisës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë mbështetur këtë kërkesë të opozitës për seancë të jashtëzakonshme.

Gjermania refuzon opsionin e shkëmbimit të territoreve

Gjermania e refuzon shkëmbimin e territoreve si zgjidhje për konfliktin prej dekadash mes Serbisë dhe Kosovës. "Ne besojmë, që kjo mund të hapë shumë plagë të vjetra në popull", tha ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas të premten (31.08) në kuadër të takimit të ministrave të jashtëm të BE-së në Vjenë. Sipas tij diskutimet për shkëmbim territorësh nuk çojnë në drejtimin e duhur. Edhe presidenca austriake e BE-së tregohet skeptike. "Ndryshimet e kufijve, sikurse e kemi parë herë pas here, nxjerrin probleme", tha ministrja e Jashtëm e Austrisë, Karin Kneissl, transmeton DW. Propozimi për shkëmbim territorësh parashikon, që pjesë të veriut të Kosovës të banuara me shumicë serbe t'i kalojnë republikës serbe. Në këmbim rajoni i Preshevës në jug të Serbisë me shumicë shqiptare t'i bashkohet Kosovës. Kosova banuar kryesisht me shqiptarë para dhjetë vjetësh u shkëput nga Serbia. Beogradi duke iu referuar manastireve dhe betejave mesjetare në Kosovë kërkon ta marrë sërish krahinën. Prej vitesh BE-ja përpiket pa rezultat që të ndërmjetësojë mes fqinjëve në konflikt. Pajtimi me Kosovën është kushti kryesor, që Serbia si kandidate për anëtarësim në BE të afrohet edhe më shumë me Brukselin. Ndër të tjerë presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe ai i Kosovës Hashim Thaçi janë shprehur për këtë opsion. Por nëse kjo do të realizohet vërtetë ka mjaft dyshime. Një nga arsyt është, që për zbatimin e një marrëveshjeje të tillë Thaçi mund t'i mungojë shumica e nevojshme në parlament.

THE ECONOMIST SHKRUAN PËR PLANIN THAÇI-VUÇIQ

"Mirëpo, nëse kufijtë vërtet riorganizohen, atëherë çfarë do të ndodhë me kufirin e Maqedonisë që ndodhet pak kilometra më larg, ku një e katërta e popullsisë është shqiptare? Dhe ç'të themi për Bosnjën, ku lideri serb, Milorad Dodik, dëshiron pavarësi nga Bosnja duke përdorur qëllimisht një gjuhë të paqartë. Dodik thotë se serbët e rajonit duhet të marrin nga fqinjët e tyre atë që u takon", shkruan The Economist

Gazeta prestigjioze britanike, The Economist, i ka dedikuar një artikull ideve të fundit për korrigjim kufijsh në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në artikull thuhet se plani i vërtetë i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologut të tij serb, Aleksandar Vuçiq mund të jetë njohja e Kosovës si shtet nga Serbia me një autonomi serbe brenda saj. "Fundi i luftërave jugosllave 20 vjet më parë la qindra mijëra njerëz nëpër vende që nuk i konsideronin si të tyre. Por paqeruajtësit vlerësuan se riorganizimi i kufijve do të çonte vetëm në konflikte të tjera. Si rezultat, rreth 120,000 serbë mbetën në Kosovën e dominuar nga shqiptarët etnikë si dhe 60,000 shqiptarë etnikë jetojnë në luginën e Preshevës në Serbi. Ka kohë që disa liderë lokalë janë të etur për një shkëmbim territorësh, mirëpo deri kohët e fundit BE dhe Shtetet e Bashkuara e kanë hedhur poshtë këtë opsion", shkruan The Economist.

Njohja e Kosovës nga Serbia me një autonomi serbe brenda saj

"Mirëpo tash kjo ka ndryshuar. Thuhet se Federica Mogherini dëshiron një njohje reciproke midis dy vendeve deri në fund të mandatit të saj si përfaqësuese e lartë e BE dhe një shkëmbim territorësh mund të jetë një nga mënyrat për të arritur një gjë të tillë", shkruan The Economist. Siç shkruan më tej kjo gazetë, Amerika nuk e kundërshton më këtë ide dhe se kjo është vërejtur me deklaratën e këshilltarit për siguri kombëtare, John Bolton.

"Zyrtarët serbë dhe kosovarë gjithashtu janë të interesuar për një gjë të tillë para zgjedhjeve parlamentare evropiane që do të mbahen në maj të vitit 2019. Kjo për arsye se zgjedhjet mund

të sjellin një komision me ide populiste që është kundër zgjerimit. Sidoqoftë, shumë analistë besojnë se Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq në të vërtetë nuk e kanë ndërmend të ndryshojnë kufijtë. Por ideja e krejt kësaj është një autonomi serbe brenda Kosovës në shkëmbim të njohjes së pavarësisë së Kosovës nga shteti Serb. Në këtë mënyrë të dyja palët do mund të thonin se kanë ruajtur territorin e tyre të çmuar. "Mirëpo, nëse kufijtë vërtet riorganizohen, atëherë çfarë do të ndodhë me kufirin e Maqedonisë që ndodhet pak kilometra më larg, ku një e katërta e popullsisë është shqiptare? Dhe ç'të themi për Bosnjën, ku lideri serb, Milorad Dodik, dëshiron pavarësi nga Bosnja duke përdorur qëllimisht një gjuhë të paqartë. Dodik thotë se serbët e rajonit duhet të marrin nga fqinjët e tyre atë që u takon".

I pyetur nga The Economist rreth rrezikut që sjell kjo ide, Shaip Kamberi i cili është kryebashkiak shqiptar i Bujanocit në luginën e Preshevës ka thënë: "Nuk jemi ne ata që po hapim Kutinë e Pandorës. Ne jemi vetë kutia!"

USHTRIA E PADUKSHME E PUTINIT

Veshja e përbërë nga trekëndësha të vogla të një materiali të veçantë të kontrolluar elektronikisht mund të mbulojë një helmetë, por edhe anën e një automjeti të blinduar dhe është në gjendje të ndryshojë ngjyrën varësisht nga mjedisi ku kalon njësia, duke reflektuar në zonë me atë që mund të krahasohet me një efekt pasqyrë

Kremlini dëshiron ta bëjë ushtrinë e tij "të padukshme" ndaj armikut dhe Rostec zbulon kamuflazhin e brezit të ri me aftësitë kameleonike, që, e adoptuar në uniformat individuale të këmbësorisë dhe automjeteve luftarake, do t'u lejojë forcave të armatosura ruse një vëzhgueshmëri shumë të ulët për të gjitha llojet e fushëbetejave. Modeli "mimik" aktiv i zhvilluar nga gjiganti mbrojtës Rostec, i cili u zhvillua fillimisht për t'u përdorur në autoblanda, është në gjendje të ndryshojë ngjyrën në varësi të mjedisit rrethues - ashtu si lëkura e një kameleoni - dhe mund të përdoret gjithashtu në industrinë e tekstilëve, që do të thotë e përshtatshme për të bërë uniforma, helmeta dhe xhaketa taktike për personelin ushtarak, siç raportohet nga agjencia ruse e lajmeve Tass.

Veshja e përbërë nga trekëndësha të vogla të një materiali të



veçantë të kontrolluar elektronikisht mund të mbulojë një helmetë, por edhe anën e një automjeti të blinduar dhe është në gjendje të ndryshojë ngjyrën varësisht nga mjedisi ku kalon njësia, duke reflektuar në zonë me atë që mund të krahasohet me një efekt pasqyrë.

Sipas raporteve të Rostec, të angazhuar tashmë në përpunimin e fibrave të karbonit "Ratnik" për njësitë e këmbësorisë - në të ardhmen materiali do të përmirësohet për të fituar aftësi shtesë, të tilla si ajo e rregullimit me shpejtësi të intensitetit të ngjyrës dhe për të simuluar efekte grafike komplekse, të tilla si "fletët që lëkunden në erë". Veshja mund të mbahet lehtë, duke lejuar zëvendësime të menjëhershme si dhe riparime direkt në terren. "Energjia që konsumon kur përdoret vazhdimisht nuk është më e madhe se ajo e një llambe me kursim dhe masa e veshjes është disa qindra gram për metër katror", thuhet në njoftimin për shtyp të zbuluar nga Tass. Drej-

tori ekzekutiv i Rostec, Sergei Chemezov, i cili më parë e kishte informuar shtypin për aftësitë e veçanta të kësaj xhakete të re të maskuar, tha se helmeta e padukshme e paraqitur në ekspozitën e Ushtrisë-2018 ishte pjesë e pajisjeve të krijuara për "ushtarin rus të së ardhmes". Testuar me sukses për të konfirmuar aftësitë e saj si një metodë ideale për maskimin e personelit, pajisjeve ushtarake dhe automjeteve të blinduara, ajo do t'u ofrohet shumë shpejt forcave të armatosura ruse, duke i bërë ato "të padukshme" ndaj kundërshtarëve.

Vëzhguar në natyrë, maskimi i zbatuar në ushtri - pra qëllimi për të bërë sa më pak të dukshëm një ushtar apo një mjet, - e ka patur fillimin e vet herët në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur, midis uniformave me ngjyra të ndritshme fuqive evropiane, për herë të parë gjetën vend uniforma me ngjyra më pak të dukshme, të tilla si ato të skautëve britanikë të cilët, duke adoptuar taktika të reja të

avancuara, mbanin uniforma pyjore. Shumë më pak të dukshme se xhaketat e çdo regjimenti tjetër të kohës.

Kjo veçori u bë një normë gjatë Luftës së Parë Botërore, kur hijet gri-jeshile dhe kaki të këmbësorisë nëpër llogore, i lanë vend ngjyrave gjithnjë e më pak të dukshme, përballë një armiku të pajisur me armë gjithnjë e më vdekjeprurëse. Gjatë Luftës së Dytë Botërore e këtij, gjermani Johann Georg Otto Schick, drejtor i departamentit të kamuflazhit të Rajhut, filloi të projektojë skemat e para të kamuflazhit, të destinuara për trupat SS: duke sjellë për herë të parë në betejë, uniforma të projektuara posaçërisht për dallueshmëri të ulët në lloje të ndryshme vegjacioni. Këto teknika do të imitohehin në modele të ndryshme për të gjithë ushtritë e botës (ndër të parët ishin pikërisht rusët), deri në prodhimin në të ardhmen uniforma të projektuara posaçërisht për zonat e shkretëtirës dhe mjediset urbane. (Il Giornale)



Për 20 vjet, nga luftërat në Afrikë kanë vdekur 5 milionë fëmijë!

Luftërat nëpër kontinentin afrikan, si dhe uria dhe sëmundjet që ato i kanë shkakuar, e kanë marrë jetën e pesë milionë fëmijëve nën moshën pesëvjeçare në 20 vitet e fundit, vlerësohet në reportazhin e revistës "Lanset". Kjo revistë mjekësore britanike i ka analizuar të dhënat nga 35 shtetet afrikane në periudhën nga viti 1995 deri në vitin 2015, ku janë regjistruar gjithsej 15,441 përleshje ushtarake në të cilat janë vrarë jo më pak se një milionë njerëz. Hulumtimi ka treguar se nga pesë milionë fëmijët të cilët e kanë humbur jetën si rezultat i këtyre përleshjeve, tre milionë nuk kanë mbushur as një vit. Arsyet kryesore për vdekjen tek fëmijët në zonat e konfliktit janë shkatërrimi i sistemit shëndetësor dhe sanitar, për çka përhapen sëmundjet vdekjeprurëse. Mungesa e ushqimit si rezultat i konfliktit gjithashtu është problem i madh në Afrikë dhe shkakton shkallë të lartë të vdekshmërisë tek fëmijët. Zonat më të rrezikshme në këtë periudhë ishin Kongo, ku me dekada të tëra ka luftë civile dhe Nigeria. Hulumtimi ka treguar se efektet nga përleshjet ushtarake ndjehen edhe në qindra kilometra nga vendi i konfliktit dhe shkaktojnë vdekshmëri tek fëmijët.

Asadi përgatitet për goditjen e fundit

Siria ka pranuar se është duke u përgatitur për një ofensivë kundër luftëtarëve rebelë në provincën Idlib, derisa aleatja e saj, Rusia planifikon realizimin e stërvitjeve detare në Detin Mesdhe



Këto hapa të Rusisë vijnë në kohën e rritjes së tensioneve me Perëndimin në këtë rajon, transmeton REL. Pasi ka biseduar me homologun e tij rus në Moskë, ministri i Jashtëm sirian, Walid al-

Moualem, ka thënë më 30 gusht se ushtria e shtetit të tij "do të hyjë në Idlib" dhe se "shënjestra fillestare" do të jetë Fronti Al-Nusra, që ka pasur lidhje me Al-Kaidën. Këto komente kanë ardhur në mesin e

shqetësimeve në rritje nga Komiteti Bashkuar dhe Perëndimi për rreziqet me të cilat përballlet popullata civile në rast të përshkallëzimit të situatës.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-

së, Antonio Guterres ka përsëritur më 29 gusht, shqetësimin e kësaj Organizate për "rreziqet në rritje të përbaljes me një katastrofë humanitare në rast të operacionit ushtarak" në Idlib. Kjo provincë përbën territorin e fundit të kontrolluar nga rebelët sunitë sirianë. Guterres u ka bërë thirrje, Qeverisë Siriane, Rusisë dhe palëve tjera të "vendosin si prioritet mbrojtjen e civilëve". Moualem u ka thënë gazetarëve se, ushtria siriane "do të bëjë gjithçka për të mënjanuar viktimitat civile" gjatë ofensivës në Idlib.

Si përgjigje ndaj paralajmërimeve të Shteteve të Bashkuara, Britanisë dhe Francës për mospër-

dorim të armëve kimike, Moualem ka pretenduar se ushtria e Sirisë nuk ka nevojë dhe se nuk posedon armë të tilla. Hetuesit në Organizatën e OKB-së për Ndalimin e Armëve Kimike kanë vlerësuar se forcat e Qeverisë Siriane kanë përdorur sarin dhe gaz klori në sulmet kundër forcave rebelë. Autoritetet siriane anën tjetër i kanë mohuar këto akuza. Më herët më 30 gusht, ministria ruse e Mbrojtjes, ka njoftuar për zhvillimin e stërvitjeve të mëdha ushtarake në Detin Mesdhe gjatë kësaj jave, teksa zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov ka thënë se situata e vështirë në Siri ka arsyetuar kryerjen e të njëjtave.



Nga Joschka FISCHER

Gjëja e fundit që do Europa është të ketë një Turqi të destabilizuar. Sado simpati apo antipati të kenë për Erdoganin, siguria e Europës varet shumë nga Turqia, e cila ka mbledhur tashmë me miliona emigrantë dhe refugjatë që janë larguar nga Lindja e Mesme. Për hir të ruajtjes së stabilitetit europian dhe të demokracisë në Turqi, BE-ja duhet të angazhohet me durim dhe pragmatizëm, duke u bazuar te parimet e veta demokratike

PO RIKTHEHET “I SËMURI” I EUROPËS

Një nga çështjet më të mëdha gjeopolitike të Europës në shekullin e 19-të ishin të ashtuquajturat Çështje Lindore. Perandoria Osmane, që në atë kohë quhej “i sëmuri i Europës”, po shpërbëhej në mënyrë të shpejtë. Tashmë mbetet për t'u parë se cila fuqi Europiane do ta zëvendësonte. Nuk ishte rastësi që vetëshkatërimi që erdhi me Luftën e Parë Botërore e pati zanafillën nga Ballkani, fushëbeteja gjeopolitike e osmanëve, austro-hungarezëve dhe perandorisë ruse.

Lufta bëri që të gjitha fuqitë e mëdha të shihnin shkatërrimin e tyre. Gjatë copëtimit të Perandorisë Osmane nga aleatët, gjenerali Mustafa Qemal Atatürk dhe ushtria e mposhtur turke u tërhoqën në Azinë e Vogël, ku shtypën me sukses një ndërhyrje nga Greqia dhe pastaj refuzuan Traktatin e Sevres. Ky i fundit u zëvendësua më pas nga Traktati i Lozanës, i cili hapi rrugën për themelimin e Republikës së Turqisë. Ambicia e Atatürkut ishte ta kthente Turqinë në një vend modern, laik, që do të ishte pjesë e Europës dhe Perëndimit, jo e Lindjes së Mesme. Për të arritur këtë qëllim ai udhëhoqi me rend autoritar dhe krijoi një shtet hibrid, të bazuar de fakto në sundimin ushtarak, dhe me demokraci pluraliste. Në vazhdim, gjatë shekullit të njëzetë, kjo formulë prodhoi kriza të përsëritura, të cilat bënë që demokracia turke të ndërpritej herë pas here nga diktatura ushtarake.

Pas vitit 1947, politika turke nisi

të ndikohet shumë nga Lufta e Ftohtë. Në vitin 1952 Turqia iu bashkua NATO-s dhe u bë një nga aleatët më të domosdoshëm të perëndimit, i cili ka përdorur për disa dekada pozicionet strategjike të Turqisë në Mesdheun Lindor dhe në Detin e Zi, duke siguruar kështu krahët e Europës nga përparimet e mundshme të Bashkimit Sovjetik. Por prapë, Turqia mbeti një vend me politikë të paqëndrueshme. Luhatjet e vazhdueshme midis demokracisë dhe diktaturës ushtarake e cunguan shumë procesin e modernizimit. Për turqit që mbështesnin demokracinë, shpresa më e mirë për të ardhmen e vendit ishte Europa. Anëtarësimi zyrtar në BE do të shënonte përfundimin e suksesshëm të procesit të modernizimit. Edhe pse osmanët e kishin sunduar Lindjen e Mesme për një shekull, Turqia duhej të bëhej anëtare zyrtare e perëndimit.

Në vitin 1995 Turqia krijoi një bashkim doganash me BE-në. Në vitin 2002, kur erdhi në pushtet partia AKP (partia e Erdoganit, Partia për Zhvillim dhe Drejtësi Islame), vendi dukej se i kishte kthyer sytë përfundimisht nga Europa. Në bashkëpunim me lëvizjen e klerikut islamik, Fetullah Cylen, qeveritë e AKP, të drejtuar nga Erdogan si kryeministër, vazhduan me reformat e kërkuara nga BE në ekonomi, në institucione dhe në gjyqësor, duke hequr madje edhe dënimin me vdekje, një parakusht thelbësor për t'u anëtarësuar në BE. Gjatë viteve

të para me Erdoganin si kryeministër, Turqia pa një zhvillim të fortë ekonomik dhe modernizim të shpejtë, gjë që e solli më afër me BE-në. Në vitin 2011, kur nisi Pranvera Arabe, Turqia shihej si demokracia islamike që duhej të ndiqej si shembull, ku zgjedhjet e lira kombinoeshim më së miri me rendin ligjor dhe me ekonominë e tregut të lirë.

Sot, shtatë vite më vonë, duket sikur po flasim për një botë tjetër. Turqia po i rikthehet me shpejtësi emërimit të mëparshëm, “i sëmuri i Europës”. Me atë vendndodhje gjeografike ideale, me potencialin e madh njerëzor dhe ekonomik që ka, Turqia duhej të ishte duke lëvizur drejt një të ardhmeje të shkëlqyer në shekullin e 21-të. Por tani po shkon prapa, drejt shekullit të 19-të, nën parullat e nacionalizmit dhe orientizmit. Në vend që të përqafojë modernizimin perëndimor, Turqia po bëhet njësh me Lindjen e Mesme dhe me krizat e shumta të atij rajoni. Erdoganin, i cili e mori presidencën në vitin 2014, e ka udhëhequr Turqinë si gjatë modernizimit të shpejtë, ashtu edhe gjatë kthimit pas, me hapa po aq të shpejtë. Ai pati mundësinë të ndiqte hapat e Atatürkut dhe të integronte Turqinë me perëndimin, por dështoi. Çfarë shpjegon kjo tragjedi? Një mundësi është që Erdoganin ka fituar vetëbesim të tepër pas zhvillimit ekonomik që erdhi para krizës financiare të vitit 2008. Një tjetër shpjegim është që mund të ketë mbledhur mëri ndaj perëndi-

mit, për shkak të vonësive me proceset e integritimit në BE, si dhe për shkak të ambicieve të veta për pushtet, të cilat i ndoqi me sukses pas tentativës për grusht shtetit ushtarak në verën e vitit 2016.

Cilado qoftë arsyeja, Erdogani ka çuar dëm një mundësi të papërsëritshme si për Turqinë, ashtu edhe për botën islame. Lira turke po vuan një zhvlerësim të madh, problem që Turqia e krijoi me duart e veta. Madje, mund të shkojë edhe drejt falimentimit ekonomik. Sa më shumë e ndan besnikërinë midis Lindjes dhe Perëndimit, aq më shumë rrezikon Erdogani ta destabilizojë Lindjen e Mesme. Konfliktet e brendshme etnike të Turqisë, sidomos me kurdët, kanë dalë sërish në sipërfaqe e madje shumë të dhunshme, edhe pse përvojat e të shkuarës kanë treguar se këto konflikte nuk zgjidhen dot me ushtri. Falë Erdoganit, Turqia tani është bërë pjesë e problemit në atë rajon, kur mund të kishte qenë pjesë e zgjidhjes. Megjithatë, Turqia mbetet me rëndësi të madhe strategjike për Europën. BE-ja ka me miliona qytetarë me origjinë turke dhe Turqia do të vazhdojë të jetë urë midis Lindjes dhe Perëndimit, Jugut dhe Veriut. Nën regjimin e Erdoganit, Turqia nuk është më një kandidate e vlefshme për në BE. Por në vend që t'ia ndërpresë plotësisht procesin e anëtarësimit, BE duhet ta ndihmojë vendin që të stabilizohet e t'i shpëtojë demokracinë.

Fundja, gjëja e fundit që do Europa është të ketë një Turqi të destabilizuar. Sado simpati apo antipati të kenë për Erdoganin, siguria e Europës varet shumë nga Turqia, e cila ka mbledhur tashmë me miliona emigrantë dhe refugjatë që janë larguar nga Lindja e Mesme. Për hir të ruajtjes së stabilitetit europian dhe të demokracisë në Turqi, BE-ja duhet të angazhohet me durim dhe pragmatizëm, duke u bazuar te parimet e veta demokratike.

(Joschka Fischer është ish Ministër i Jashtëm i Gjermanisë dhe zv/Kancelar në vitet 1998-2005. Gjatë mandatit të tij, Gjermania mbështeti me forcë ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, dhe po me aq forcë kundërshtoi ndërhyrjen në Irak)



U-21, BUSHI PUBLIKON LISTËN E LOJTARËVE KUNDËR SPANJËS

Duke u ndalur sërish tek kombëtarja kuqezi, e cila e ka nisur me humbje epokën e re, pas largimit të De Biazit, Bushi ka vlerësuar punën e bërë nga Panucci, sipas së cilit, e menaxhon shumë mirë lojën, edhe pse ekipi nuk është aspak në një periudhë të mirë. Ai gjithashtu ka zbuluar se Meritan Shabani është shumë pranë afrimit me këtë kombëtare

Trajneri i kombëtares U-21, Alban Bushi ka bërë publike listën e futbollistëve të grumbulluar për ndeshjen zyrtare që do të luhet përballë Spanjës në datën 6 shtator. Ajo që trajneri kuqezi ka theksuar që në një të konferencës për shtyp të mbajtur mesditën e së premtes në ambientet e FSHF, është se pjesë e kësaj liste nuk janë "veteranët" si Laçi, Çollaku, Toli, Dyrmishaj, Krymi, Bytyçi. Sipas tij, një vendim i tillë është marrë për shkak të moshës së tyre, pasi nuk mund të grumbullohen për eliminatorët e tjera.

"Dua të përsërites të gjithë lojtarët që kanë qenë pjesë e Kombëtares U-21 dhe që tani nuk janë më. Laçi, Çollaku, Toli, Dyrmi-



Stadiumi "Nuevo Arcangel" në Cordoba/Spanjë

Nr.	Emër	Mbiemër	Psicioni	Ekipi	Ditëlindja
1.	Elhan	Kastrati	Portjer	Pescara	02.02.1997
2.	Gentian	Selmani	Portjer	KF Laci	09.03.1998
3.	Alessio	Abibi	Portjer	Tirana	04.12.1996
4.	Orilon	Kryeziu	Mbrojtës	NK Triglav Kranj	01.07.1999
5.	Shaqir	Tafa	Mbrojtës	AC Cuneo 1905	14.11.1998
6.	Leonardo	Maloku	Mbrojtës	Alma Juventus Fano 1906	18.05.1998
7.	Esin	Hakaj	Mbrojtës	Teuta	06.12.1996
8.	Albi	Doko	Mbrojtës	Tirana	26.06.1997
9.	Marash	Kumbulla	Mbrojtës	Hellas Verona	08.02.2000
10.	Kristal	Abazaj	Mesfushor	Anderlecht	06.07.1996
11.	Ylber	Ramadani	Mesfushor	Veje BK	12.04.1996
12.	Lindon	Selahi	Mesfushor	Standard Liege	26.02.1999
13.	Marlind	Nuriu	Mesfushor	Dinamo	05.07.1997
14.	Emir	Sahiti	Mesfushor	Hajduk Split	29.11.1998
15.	Keidi	Bare	Mesfushor	Atletiko Madrid	28.09.1997
16.	Arbin	Zejnullaj	Mesfushor	FC Shkëndija Tetove	15.02.1999
17.	Arbnor	Mucolli	Mesfushor	Veje BK	15.09.1999
18.	Taulant	Sulejmanov	Mesfushor	Winterthur FC	15.11.1996
19.	Endri	Cekici	Mesfushor	Dinamo Zagreb	23.11.1996
20.	Rubin	Hebah	Sulmues	Partizani	30.07.1998
21.	Shefit	Shefiti	Sulmues	FC Shkëndija Tetove	19.02.1998
22.	Giacomo	Vrioni	Sulmues	Venezia	15.10.1998

shaj, Krymi, Bytyçi, nuk janë grumbulluar pasi janë të ditëlindjes 96-97 dhe nuk i mendojmë për sezonin tjetër. Dua t'i falënderoj pasi kemi kaluar kohë të mirë me ta, nuk është se nuk janë këtu për shkak të meritës, por për shkak të moshës duke qenë se kombëtarja po riorganizohet për sezonin tjetër dhe në përbërje të saj duam loj-

tarë të ditëlindjes 98", u shpreh Bushi. Ajo që bie në sy në listën e prezantuar nga Bushi është edhe prania e dy lojtarëve, i Kristal Abazajt dhe Ylber Ramadani që vijnë nga kombëtarja A. I pyetur për motivet përse ky kthim prapa i trajnerit Panucci, Bushi është përgjigjur thjesht se bëhet fjalë për arsye teknike ose taktike që kanë ndikuar

Arlind Shabani ftohet nga Kombëtarja Shqiptare

Talenti i Trepçës '89, Arlind Shabani pritet ta veshë fanellën e Kombëtares së Shqipërisë për grupmoshën U-19. Mesfushori i talentuar është monitoruar nga skautët e FSHF-së gjatë përgatitjeve të Trepçës '89 në Ohër dhe tashmë ka pranuar ftesën dhe gjatë ditëve në vijim pritet vendimi final i tij. Shabani është vetëm 16-vjeçar dhe stërvitet me ekipin e parë të Trepçës '89. Ai më parë ka luajtur te KEK-u, teksa për nga loja dhe stili ngjan me kroatian, Luka Modric. Lojtari është nën përkujdesjen e menaxherit të njohur, Shkëmbim Qorrmehmeti. Shabani pritet që gjatë muajit janar të provohet në Belgjikë. Ndryshe, deri më tash ai nuk ka marrë ftesë nga Përfaqësuesja e Kosovës.

tek italiani për të marrë një vendim të tillë.

Duke u ndalur sërish tek kombëtarja kuqezi, e cila e ka nisur me humbje epokën e re, pas largimit të De Biazit, Bushi ka vlerësuar punën e bërë nga Panucci, sipas së cilit, e menaxhon shumë mirë lojën, edhe pse ekipi nuk është aspak në një periudhë të mirë. Ai gjithashtu ka zbuluar se Meritan Shabani është shumë pranë afrimit me këtë kombëtare.

"Po të isha si ju, mund të thosha që kombëtarja nuk është mirë, por duke e parë si trajner, jemi në një periudhë shumë të keqe sepse lojtarët kanë pak minuta, disa prej tyre janë pa ekip, kurse nga anët e tjera më ka pëlqyer shumë si Panucci e menaxhon lojën, dua ta falënderoj dhe t'i uroj suksese për sezonin e ri. Meritan Shabani është shumë pranë kalimit te kombëtarja A", tha Bushi.



Shqiptarët mbeten pa Europë, eliminohen Atalanta e Baseli



Etrit Berisha, Berat Xhimshiti dhe Taulant Xhaka nuk do të jenë pjesë e fazës së grupeve të Europa League. Edhe pse asnjëri prej tyre nuk u aktivizua për asnjë minutë e enjtja ishte një ditë për t'u harruar për skuadrat e lojtarëve shqiptarë në Europa League, me përjashtim

të Qarabagut të Ansi Agollit që mposhti 3-0 Sherifin e Tiraspolit dhe avancoi në fazën e grupeve, edhe pse Agolli nuk luajti për asnjë minutë në këtë sfidë, ashtu si Berisha, Xhimshiti e Xhaka.

Atalanta u tradhtua pikërisht nga një danez në sfidën ndaj FC

Copenhagen, ai dhe kapiteni Papu Gomez humbën penalltitë vendimtare pasi edhe ndeshja e kthimit bashkë me kohën shtesë përfunduan në barazim pa gola ashtu si ndeshja e parë. Me penallti triumfoi Copenhagen me rezultatin 4-3, me ish sulmuesin e skuadrës daneze Cornelius që i ardhur në fushë nga stoli, gabo penalltinë vendimtare për Atalantën që në këtë sezon nuk do të jetë pjesë e fazës së grupeve të Europa League. Ndërkohë një supergol i Kyriakou në minutën e 53-të kualifikoi në fazën e grupeve qipriotët e Apollon Limasol dhe eliminoi nga ky kompeticionin Baselin që me humbjen 1-0 në transfertë doli jashtë Europës pasi në shtëpi kishte fituar me shifrat 3-2.

Zyrtare: Grezda në Rangers




Ashtu siç pritej, futbollisti kosovar Eros Grezda është transferuar tek Glasgow Rangers. 23 vjeçari nga Gjakova e kishte nisur karrierën profesionale me ekipet slovene Aluminij e Zavrç, ndërsa më pas ishte transferuar në Kroaci, fillimisht tek Lokomotiva e Zagrebit e më pas tek Osijeku. Grezda bëhet transferi numër 14 i trajnerit Steven Gerrard këtë verë dhe trajneri i ri anglez beson se lojtari do t'ju pëlqejë menjëherë

tifozëve. "Ai është një lojtar i shkëlqyeshëm dhe tifozët do ta duan atë, sepse ai mund të kontribuojë në sulm. Është mjaft i shpejtë, direkt dhe vjen me një eksperiencë ndërkombëtare", ka thënë Gerrard. "Ai është lojtar i rrezikshëm. Duhet të jemi falënderues që nuk ishte në gjendje të luante ndaj nesh. Shpresojmë që ai do të jetë një lojtar i madh yni", ka përfunduar legjenda e Liverpoolit.

SHORTI I GRUPEVE TË EUROPA LEAGUE

Nga Montekarlo, ku një ditë më parë u hodh edhe shorti i fazës së grupeve të Champions League, këtë të premte është mësuar edhe ndarja e skuadrave që do të luftojnë për trofeun e dytë për nga rëndësia në kontinentin evropian. Shorti është hedhur duke nisur nga ora 13:00, e së pari është vlerësuar me çmimin si "lojtari më i mirë i edicionit të kaluar të Europa League", sulmuesi francez i Atletico Madrid, Antoine Griezmann, njëkohësisht edhe kampion bote gjatë verës me Francën e tij. Sa u përket grupeve, 36 skuadrat u ndanë në 12 të tilla me nga 4 ekipe, me goglat që i zbuloi ish-futbollisti Hernan Crespo, e ku spikasin grupi F, me Milanin që do të ndeshet me Olympiacosin, Betisin dhe Dudelangen, si dhe grupi H, ku Lazio do të luajë ndaj Marseille, Frankfurtit dhe Apollon Limasolin. Qarabagu, skuadra e qytetit ku do të luhet edhe finalja e këtij sezoni të Europa League, e ku militon edhe ish-kapiteni i Kombëtares kuqezi, Ansi Agolli, do të ndeshet në grup me Arsenalin, Sportingun e Lisbonës dhe Vorskla Poltavën. Ndërsa Chelsea do të luajë ndaj PAOK-ut të Selanikut, BATE Borisovit dhe Videotonin.

EUROPA LEAGUE		
GROUP A	GROUP B	GROUP C
LEVERKUSEN LUDOGORETS ZÜRICH AEK LARNACA	SALZBURG CELTIC LEIPZIG ROSENBORG	ZENIT KØBENHAVN BORDEAUX SLAVIA PRAHA
GROUP D	GROUP E	GROUP F
ANDERLECHT FENERBAHÇE DINAMO ZAGREB SPARTAK TRNAVA	ARSENAL SPORTING CP QARABAĞ VORSKLA	OLYMPIACOS MILAN BETIS DUDELANGE
GROUP G	GROUP H	GROUP I
VILLARREAL RAPID WIEN SPARTAK MOSKVA RANGERS	LAZIO MARSEILLE FRANKFURT APOLLON	BEŞİKTAŞ GENK MALMÖ SARPSBORG
GROUP J	GROUP K	GROUP L
SEVILLA KRASNODAR STANDARD LIÈGE AKHISAR	DYNAMO KYIV ASTANA RENNES JABLONEC	CHELSEA PAOK BATE VIDI



Griezmann shpallet Lojtari më i Mirë i Evropa Ligës

Antoine Griezmann i Atletico Madridit është shpallur Lojtari më i Mirë i Sezonit 2017/2018 në Evropa Ligë. Griezmann nuk ishte i pranisëm në Monako për ta pranuar çmimin, pasi Atletico do të luajë sot në udhëtim kundër Celta Vigos, por ai e ka incizuar një mesazh për nderimin që i është bërë. "Jam shumë krenar dhe ndihem i nderuar për këtë çmim. Dua t'i falënderoj të gjithë që votuan për mua. Në veçanti, dua ta falënderoj trajnerin tim, stafin teknik dhe mjekësor dhe natyrisht bashkëlojtarët. Ky çmim është edhe për përkrahësit", tha Griezmann në mesazhin e tij. Sulmuesi francez ishte lojtari kryesor i Atletico në fitimin e Evropa Ligës sezonin që lamë pas. Në garë për këtë çmim, Griezmann i imposhti Diego Godinin dhe Dimitri Payetin.



Reali synon Mario Hermoson

Ekipi i Real Madridit është duke e konsideruar mbrojtësin Mario Hermoso-n si një zëvendësim të mundshëm të Jesus Vallejo-s. Vallejo është në prag të transferimit me afat një vjeçar në Real Sociedad dhe Hermoso është opsioni i preferuar i Madridit për t'i zënë vendin 21 vjeçarit. Hermoso i cili është 23 vjeçar kaloi 11 sezone në akademinë e të rinjve në Madrid dhe mund të luajë në qendër të fushës ose në mbrojtje. Ai është në dispozicion që të nënshkruajë kontratë blerje prej 15 milion eurosh.

U kapën me prostituta, pezullohen 4 basketbollistët japonezë



Dënim mjaft i rëndë për 4 lojtarë të kombëtares japoneze të basketbollit, të cilët janë squalifikuar për 1 vit, pas skandalit në Lojërat Aziatike javën e kaluar.

Lojtarët Takuma Sato, Nagayoshi Yuga, Takuya Hashimoto dhe Keita Imamura, e kishin tepruar me festimin e tyre në qytetin e Xhakartas të Indonezisë, ku janë kapur në një lokal nate me 4 prostituta. Madje ata ishin të gjithë të veshur me uniformën e kombëtares së tyre, që me siguri e ka bërë më të lehtë për t'u dalluar. Reagimi

i federatës japoneze ishte i menjëhershëm. Vetë kreu i basketbollit në vend, deklaroi se sjellja e lojtarëve ishte e papranueshme, duke zhgënjyer të gjithë besimin e botës së sportit dhe jo vetëm, në Japoni.

Ndërkohë lojtarët kanë kërkuar falje publike, duke shoqëruar fjalimin e tyre me shumë përrulje. E vetmja gjë që ata kanë arritur të marrin, është stërvitja me shokët e skuadrës gjatë këtij sezoni, edhe pse nuk do të kenë mundësi të luajnë.

US OPEN

Favoritët kalojnë tutje

Pretendentët kryesorë për fitoren e turneut të fundit "Grand Slam" të vitit, "US Open", nuk i zhgënjyen tifozët e tyre. Roger Federer kaloi në raundin e tretë të turneut, pasi mundi francezin Benoit Paire me rezultatin 3-0. Numri dy i renditjes botërore hasi vështirësi vetëm në setin e parë kundrejt rivalit të tij, duke e fituar këtë fraksion 7-5. Më pas, Federer nuk i lejoi asgjë Pairesë në lojë, pavarësisht përpjekjeve të këtij të fundit, me zviceranin që fitoi dy setet e tjerë me të njëjtin rezultat 6-4.

U kualifikua për në raundin e tretë edhe Novak Djoković, që eliminoi amerikanin Sandgren me rezultatin 3-1. Seti i parë ishte një



formalitet për tenistin serb, që e nbylli atë 6-1. Por, Sandgren u kundërpërgjigj në të dytin, të cilin e fitoi 6-3. Seti i tretë ishte më i

ekuilibruari i kësaj sfide, me Djoković që e fitoi me "tiebreak" 7-6, ndërkohë që të katërtin e fitoi me lehtësi 6-2. Në kampin e femrave u kualifikua për në raundin e tretë të "US Open", Maria Sharapova. Tenistja ruse, numri 22 i botës, mundi rumunen Cirstea me rezultatin 2-0. Sharapova fitoi pa probleme setin e parë 6-2, ndërkohë që në të dytin Cirstea rezistoi më shumë.

Gjithsesi, edhe ky fraksion shkoi në favor të ruses, që e fitoi 7-5. Vuajti jo pak Jelena Ostapenko në ndeshjen ndaj amerikanes Townsend, të cilën e mundi 2-1. Townsend fitoi setin e parë 6-4, por letonezja reagoi dhe fitoi dy setet e tjerë 6-3 dhe 6-4.

Guendouzi ka një pjesë të madhe të meritave. Ai është lindur i tillë dhe ai ka pasur guxim gjatë edukimit të tij. Ai tregoi fuqinë dhe kualitetin e njëjtë që po e tregon te Arsenalit shumë herët, gjë që do të thotë se ai ishte shumë vetëbesues me topin, i thjeshtë, kishte vizion dhe aftësi teknike. Ai i ka pasur të gjitha këto që prej fillimit

Matteo Guendouzi është sensacioni më i fundit tek Arsenalit. Pakkush do ta mendonte se ish-ylli i Lorientit do të kishte hapësirë të madhe te klubi londinez në këtë fillim të edicionit. Por, vendosmëria dhe paraqitjet e tij të mira në fazën përgatitore të anglezëve kanë bërë që ai të vlerësohet lart nga Unai Emery. Derisa një epokë e re ka filluar në "Emirates", është një transferim i ri që ka marrë vëmendjen e Arsenalit të Unai Emerys. Lucas Torreira pritej që t'i zinte ballinat e gazetave pas transferimit në Arsenal, por është mesfushori 19-vjeçar Matteo Guendouzi që është vënë në qendër të vëmendjes.

Me vetëm tetë paraqitje në një ligë elitare, Guendouzi nuk pati ndonjë bujë të madhe pasi u transferua nga klubi i kategorisë së dytë franceze Lorient te Arsenalit për 7 milionë funte në korrik. Por, pasi luajti një rol kyç në fitoren 5:1 të Arsenalit ndaj Paris Saint-Germainit në një miqësore pati zëra të shumtë rreth Londrës Veriore që thoshin se ai mund të ketë një ndikim të menjëhershëm. Lënia jashtë e Torreiras, një lojtar që u paraqit si titullar në të pesë ndeshjet e Uruguait në Kupën e Botës, në mesfushën e Arsenalit në ndeshjen e parë të londinezëve, në Premierligë kundër Manchester Cityt, ishte jashtë të gjitha pritjeve. Kështu ishte edhe paraqitja e Guendouzit. "Nuk e kisha parë kurrë këtë djalosh, kam dëgjuar për të, por kurrë nuk e kam parë duke luajtur, kështu që isha shumë i impresionuar nga stërvitja e parë", ka deklaruar bashkëlojtari Henrikh Mkhitaryan. "Është një surprizë pozitive, shumë e madhe", ishte shprehur Unai Emery.

Sidoqoftë, starti i furishëm i Guendouzit nuk është një befasi. Ishte filozofia e akademisë së Lorientit që e ndihmoi atë në formimin e tipareve të guximshme, gjë që e ka ndihmuar atë të qëndrojë me këmbë në tokë gjatë progresit të tij dhe shmangies së të qenët i mbingarkuar në javët e tij të para me Arsenalin. I lënë i lirë nga Paris Saint-Germaini në moshën 14-vjeçare, ai ishte pjesë kyçe e kiptit U-17 të Lorientit, që u shpallën kampionë në Francë në 2015-ën dhe gjithashtu ai ishte pjesë e ekipit U-19 dy vjet më pas në humbjen ndaj

GUENDOUZI I VENDOSUR PËR T'I ARRITUR MAJAT



Auxerres në çerekfinalen e Kupës së Francës për të rinj.

Siç ndodh edhe në çdo klub, të tjerët rreth tij dobësoheshin derisa Guendouzi vazhdonte të "lulëzonte". Ndoshta diferenca kishte të bënte me vendosmërinë dhe kokëfortësinë e tij, që më vonë do t'i kushtonte edhe me disa probleme. "Lorienti njihet për luajtjen e një stili të vetëm", thotë gazetari sportiv Arnaud Huchet, i cili mbulon ngjarjet për Lorientin. "Christian Gourcuff (babai i ish-lojtarit të Milanit, Yoann) ishte trajner i Lorientit në dy periudha dhe ishte një mësues i vërtetë i futbollit. Ai është shumë i respektuar në Francë. Ai e zhvilloi atë stil për Lorientin në mënyrë që ata të kishin një formë të mësimit për lojtarët e rinj, por Guendouzi ka një pjesë të madhe të meritave. Ai është lindur i tillë dhe ai ka pasur guxim gjatë edukimit të tij. Ai tregoi fuqinë dhe kualitetin e njëjtë që po e tregon te Arsenalit shumë herët, gjë që do të thotë se ai ishte shumë vetëbesues me topin, i thjeshtë, kishte vizion dhe aftësi teknike. Ai i ka pasur të gjitha këto që prej fillimit", shprehet ai.

Personaliteti dhe aftësi e tij e ka ndihmuar Guendouzin që të impresionojë në çdo nivel që ka luajtur dhe pas disa paraqitjeve të mira në skuadrën B në kategorinë e katërt bënë që trajneri Sylvain Ripoli të vendosë ta ftojë futbollistin në ekipin e parë në edicionin 2016/2017. "Ai kishte zhvilluar një reputacion të mirë me ekipin e të rinjve dhe ishte një progres natyral për të. Ai është dukur si David Luiz, kështu që në Francë kur u pa për herë të parë në televizionin kombëtar kishte komente që bënin që ai tashmë të njihej para se njerëzit të shikonin talentin e tij", shtoi Huchet. Kur Ripoli ishte

Në krishtlindjet e kaluara, Manchester City dhe Tottenhami po vëzhgonin progresin e Guendouzit, por pak pas kësaj periudhe - ata nuk kishin çfarë të shihnin, sepse lojtari ishte përjashtuar nga skuadra e Lorientit. Tensionet ishin rritur pasi ai kishte refuzuar të nënshkruante marrëveshje të re me klubin dhe një zënkë me Landreaun nuk e ndihmoi



shkarkuar dy muaj pas fillimit të edicionit, zëvendësuesi Bernard Casoni, një trajner me stil mbrojtës, nuk ishte i impresionuar me stilin e hapur të lojës, të cilën normalisht nuk pranonte ta pranonte. Vetëm kur Casoni u shkarkua dhe Mickael Landreau mori detyrën pas rënies nga liga në 2017-ën bëri që gjërat të përmirësoheshin për sulmuesin.

Në krishtlindjet e kaluara, Manchester City dhe Tottenhami po vëzhgonin progresin e Guendouzit, por pak pas kësaj periudhe - ata nuk kishin çfarë të shihnin, sepse lojtari ishte përjashtuar nga skuadra e Lorientit. Tensionet ishin

rritur pasi ai kishte refuzuar të nënshkruante marrëveshje të re me klubin dhe një zënkë me Landreaun nuk e ndihmoi. Në mesin e këtyre ngjarjeve, presidenti Loic Fery deshi të ndërtonte disa ura lidhëse me talentin e premtuar të klubit. "Ai është shumë i talentuar dhe nuk mund ta fsheh se sa shumë e vlerësoj atë. Jam përfshirë personalisht në zhvillimin në kohën kur nënshkroi kontratën e parë profesionale, por edhe më shumë gjatë procesit të vazhimit të saj. Por, pavarësisht afinitetit personal, unë i marr vendimet e tij në bazë të zgjedhjeve sportive, që përfshijnë integritetin e grupit në fushë", kishte thënë Fery.

Guendouzi eventualisht u rikthye në ekip, por shpresa për një pajtim ishte e vogël, e vonshme. Tifozët janë lutur për një zgjidhje me rezultatet që ishin më të dobëta pa të në ekip dhe marrëveshjet i kushtuan klubit me humbjen e pozitës për "Play-Off". Ylli i Lorientit u shit për 7 milionë funte në fund të sezonit të kaluar, një shumë mjaft e madhe për lojtarë të ligës së dytë franceze. Nëse do të kishte një fund të lumtur mes palëve, ishte ky fund. Por, a do të jetë ai i domosdoshëm për Arsenalin siç ishte për klubin e vjetër? "Ai ka aftësitë futbollistike për të shkuar lart. Por, në terme të fuqisë fizike nëse do të kishte një mesfushor të madh, me fizik sikur të Patrick Vieiras në Arsenal, ai do të vuante shumë për të hyrë në skuadër në këtë moment. Është paksa herët të thuhet nëse ai do të ketë një karrierë fantastike dhe nëse ai e ka fuqinë mendore. Por, ai është i ri dhe ka vetëbesim me topin, ka aftësi të mira teknike, vizion, gjë që e ka treguar qysh në fillim", përfundon Huchet.



Çmimet UEFA, reagon Salah

Edhe pse nuk e ka fituar asnjërin nga dy çmimet për të cilët ishte nominuar nga UEFA për vitin 2018, ylli i Liverpoolit, Mohamed Salah, ende ndihet i motivuar. Të enjten, sulmuesi i Juventusit, Cristiano Ronaldo, dhe mesfushori i Real Madridit, Luka Modric, i fituan çmimet: Sulmuesit i Vitit dhe Lojtari i Vitit, respektivisht, duke e lënë kështu Salahun - njeriun që i shënoi 44 gola sezonin e kaluar - të kthehet duar thatë nga Mocano. Megjithatë, Salah, i cili konsiderohet të jetë shembull për t'u ndjekur nga '100 milionë egjiptianë', është zotuar se do të vazhdojë të bëhet version më i mirë i vetes. "Kur bën diçka për herë të parë, që askush nuk e ka bërë si egjiptian më herët, diçka madhështore, është diçka për të cilën duhet të jem krenar", tha Salah. "Janë 100 milionë egjiptianë që më marrin shembull mua. Kjo është diçka për të cilën duhet të krenohem", shtoi ai. "Nganjëherë e ndien presionin për shkak të kësaj, por në të njëjtën kohë të bën të punosh më fuqishëm dhe më mirë", theksoi ai.



Ramosi e arsyeton mungesën e Ronaldos në çmimet e UEFA-s

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, ka dalë në mbrojtje të ish-bashkëlojtarit Cristiano Ronaldos, i cili mungoi në çmimet që i dhuroi UEFA të enjten gjatë hedhjes së shortit në Monaco. Sulmuesi portugez që iu bashkua Juventusit për 100 milionë euro gjatë verës, nuk ishte prezent, ndërsa spekulimet thonë se ai e ka ditur se ish-bashkëlojtari i tij te madriënët, Modriqi, do ta fitonte çmimin. "Nuk mendoj se Cristiano nuk është i lumtur për Modriqin. Ai ndoshta nuk është i kënaqur që nuk e ka fituar ai, por jo pse e ka fituar ish-bashkëlojtari i tij. Nëse një futbollist e meritonte këtë çmim, atëherë ai do të duhej të ishte Luka", deklaroi Ramos. Modriqi e fitoi çmimin si futbollist dhe mesfushor më i mirë nga UEFA për edicionin që e lamë pas, Navas u shpall portieri më i mirë, ndërsa Ramosi e mori trofeun si futbollist më i mirë në mbrojtje.

Gjashtë futbollistë të Interit rrezikojnë pjesëmarrjen në "Champions"

Gjashtë lojtarë të Interit rrezikojnë që të mos jenë pjesë e 22 futbollistëve të "Nerazzurrëve" në skuadrën që do të luajë në Ligën e Kampionëve. Kufizimi i Fair-Playit Financiar do të thotë se Interi mund t'i emërojë vetëm 22 futbollistë për "Champions", dy nga ta që janë rritur nga "Zikaltrit", ndërsa prej tyre që do të lihen jashtë, mund të jetë ndonjëri që kush-ton më shumë se 20 milionë euro.

Sipas "Tuttosport", portieri i tretë Tommaso Berni që do të zëvendësohet nga Raffaele Di Gennaro është rritur te klubi italian. Joao Mario është në dyshim, po ashtu, pasi nuk është në planet e Luciano Spalletit, dhe çmimi i tij është 43.7 milionë euro.

Gazeta italiane bën të ditur, gjithashtu, se dy prej Roberto Gagliardinit, Matias Vecinos, Antonio Candrevas dhe Dalbertit, që të gjithë me çmim mbi 20 milionë euro, do t'i bashkohën portugezit. Interi do të bëjë gara në Ligën e Kampionëve në Grupin B së bashku me Barcelonën, Tottenhamin dhe PSV-në.



MARCHISIO VLERËSON OFERTAT

KOHË RINOVIMESH TE NAPOLI



Napoli duket se ka mësuar nga gabimet e së shkuarës për sa i takon rinovimeve të kontratave të lojtarëve që janë në prag të skadencës. Klubi i kaltër këtë herë vendosi të "blindojë yjet", edhe pse kontratat e tyre janë afatgjata, duke nisur menjëherë punën për të firmosur me Koulibaly e Zielinski

Kanë kaluar dy javë nga largimi i Claudio Marchisios nga Juventus, por lojtari ende nuk ka gjetur një skuadër të re, pavarësisht se ofertat nuk mungojnë. 32-vjeçari po i vlerëson për të zgjedhur mundësinë më të mirë. Një nga alternativat më të mundshme është transferimi në Portugali, ku Porto është në kërkim të një mesfushori me eksperiencë për të përballuar sfidat në Champions League. Për italianin nuk mbetet pas as oferta e Zenitit, por edhe Monaco është në ndjekje të Marchisios, që duket se e pëlqen kalimin në Principatë.

Napoli duket se ka mësuar nga gabimet e së shkuarës për sa i takon rinovimeve të kontratave të lojtarëve që janë në prag të ska-

dencës. Klubi i kaltër këtë herë vendosi të "blindojë yjet", edhe pse kontratat e tyre janë afatgjata, duke nisur menjëherë punën për të firmosur me Koulibaly e Zielinski. Nëse për mbrojtësin 27-vjeçar çdo gjë duket e përfunduar, me lojtarin që do të firmosë deri në vitin 2023, për polakun bisedimet për rinovimin sapo kanë nisur. Gjithsesi, një nga ngërçet që De Laurentis duhet të zgjidhë është çështja e klauzolës në kontratat e lojtarëve që, si për Koulibaly dhe për Zielinskin, parashikohet të kapë shifrën e 200 milionë eurove.

Edhe pse merakto në Itali ka thuar dy javë që është mbyllur, ekipet kanë nisur nga puna, duke planifikuar strategjitë për merkaton e Janarit. Juventus nuk dorëzohet për Giacomo Bonaventurën, të cilin do ta tentojë në fillim të

vitit 2019 me hapjen e merkato së dimrit. Mesfushori i Milanit ka kohë që ndiqet me interes nga bardhezinjtë, pasi pëlqehet shumë nga trajneri Allegri, i cili kërkon me ngulm ta transferojë në Torino. Kuqezinjtë nga ana e tyre mund ta lënë të lirë 29-vjeçarin vetëm në rast se i prezantohet oferta e duhur.

Adem Ljajic do t'i japë lamtumirë Serisë A, pasi e ardhmja e tij do të jetë në Turqi. Futbollisti do të transferohet te skuadra e Besiktasit, pasi pas shumë tratativash më në fund Torino dhe drejtuesit e klubit turk kanë arritur marrëveshjen për kalimin e futbollistit nën urdhrat e trajnerit Senol Guner, që kishte kohë që e kërkonte lojtarin. 26-vjeçari do të transferohet në kampionatin turk në formë huazimi me të drejtë belerjeje për 8 milionë euro.

VAR-i? Ka gjëra për të përmirësuar

Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, i kthehet edhe herë debatit për sistemin VAR. Slloveni nuk u duk aq i sigurt në përdorimin e tij gjatë këtij sezoni, ku shumë klube e kanë kërkuar që në fazën me eliminim direkt të Champions League. "Për mendimin tim, VAR-i duhet të përdoret në finalen e ardhshme të Superkupës së Evropës, që do të zhvillohet në Stamboll, e më pas në playoff të Champions League. Ka gjëra që duhen përmirësuar, por në Botëror funksionoi shumë mirë".

Ceferin u ndal gjithashtu tek riformatimi i mundshëm i Champions League, por dhe tema të tjera që i përkasin institucionit më të lartë të futbollit evropian: "Në të ardhmen, sigurisht që do të ndryshojmë diçka. Aktualisht po bisedojmë me klubet për këtë gjë. E sigurt është se nuk do të ketë kurrë një turne vetëm me klubet e mëdha, do të ishte e mërzitshme dhe nuk do të ndihmonte futbollin.



Në vitin 2024 do të shohim se çfarë mund të bëjmë". Ceferin në javët e shkuara ka konfirmuar rikandidimin e tij për president të UEFA-s. Ai e morri këtë detyrë në vitin 2016, pas përjashtimit të Michel Platini.

Marcelo mund të largohet

Drejtuesit madrilenë janë duke tentuar ta transferojnë në ditën e fundit të afatit kalimtar, futbollistin e Chelseat Marcos Alonso. Dhe nënshkrimi i Alonsos, mund të hapë rrugën për largimin e Marcelos, nga Real Madridi. Juventus është skuadra që ka shprehur interesim për e transferimin mbrojtësit brazilian, që mund të kushtojë 50 milionë euro, në verën e vitit të ardhshëm.



"MODRIC": S'më kishte ndodhur kurrë, e donin pa para



Buzëqesh Florentino Perez kur flitet për Luka Modricin, më pak kur diskutimi shkon te Cristiano Ronaldo, e kjo është mëse e kuptueshme. Kroati vendosi të qëndronte te Reali i Madridit, pavarësisht zërave të shumtë që flisnin për një transferim tek Interi. Për këtë presidenti i Realit u shpreh:

"Sigurisht që qëndroi. Interi kërkoi të merrte një numër 10 si ai pa paguar asgjë. Kjo gjë nuk më ka ndodhur kurrë në jetën time".

Ndërkohë, zëvendëspresidenti i Interit, Javier Zanetti, tha se nuk kishte dëgjuar për akuzat e Perez, por siguroi se do të flitet për to në vendet e duhura.

Edhe pse merkatoja është mbyllur, gjakrat vazhdojnë të jenë të nxehtë mes 2 klubeve sa i përket mesfushorit kroat. Luka Modric bëri tifozët zikaltër të ëndërrojnë në fillim të gushtit, por si përfundim qëndroi në Madrid. Reali ka denoncuar Interin në FIFA, pasi ka

kontaktuar lojtarin pa njoftuar fillimisht kampionët e Evropës. Pas denoncimit, erdhi menjëherë përgjigja e Interit, që dërgoi në Zyrë një letër me 2 faqe, duke iu përgjigjur të gjitha akuzave. Ata pretendojnë se ishte agjenti i Modric, Vlado Lemic, i cili e propozoi lojtarin, por ata nuk kanë kontaktuar kurrë me nënkampionin e botës. Mbetet për t'u parë se cili do të jetë vendimi i FIFA në lidhje me këtë situatë.



DASHI 21. mars - 20. prill

Po afrohen ndryshime mjaft pozitive sa i takon sferës profesionale financiare. Intuita juaj ju fton që të bëni përpara me projekte të reja. Kjo e premtë parashikon takime të shkëlqyera edhe në mbrëmje.



DEMI 21. prill - 21. maj

Largësia nga personi që doni ose nga familja ju bën tejet nervoz dhe të acaruar. Kjo e premtë do të jetë mjaft e mirë për tu rrethuar nga aleatë të vlefshëm dhe për të bërë negociata vendimtare sa i takon karrierës tuaj profesionale.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikohet një ditë e cila do të jetë e mbushur me negativitet dhe pesimizëm, si në sferën e dashurisë edhe në atë të takimeve. Çfarëdo keqkuptimi, do mund të zgjidhet me më shumë dialog. Këshillohet të jeni ju të parët që të kërkon ballafaqim.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ky është një moment shumë i mirë për të rigjetur veten dhe forcë brenda jush. Kohëve të fundit keni qenë disi të rrëzuar me humor, por tashmë do të merrni përgjigje të cilat do ju lejojnë që të bëni një rikuperim të madh.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Merrni më shumë kohë për të menduar për veten tuaj dhe shëndetin. Po afrohen mundësi shumë të mira për të rindezur dashurinë dhe ndjenjat, por duhet të jeni më të hapur dhe të gatshëm në raport me të tjerët.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo fundjavë është e rëndësishme për të rigjetur kapacitetin brenda vetes. Këshillohet që të lini mënjanë të gjitha zhgënjimet dhe nervozizmin e së kaluarës dhe të merrni me planifikime të reja në punë. Parashikohen fitore të mëdha.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Shmangni sjelljen shumë kontradiktore në vendin e punës. Kjo pasi në këtë moment edhe shpërqendrimi më i vogël mund të shkaktojë tensione dhe pengesa. Në dashuri do të jeni romantik dhe të kujdesshëm.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kryefjala e ditës është qetësia, por ka disa afate që duhet ti respektoni dhe disa problematika që duhet ti zgjidhni. Megjithatë duhet të udhëhiqeni nga intuita dhe mos u përfshini nga paniku. Në dashuri do të ketë konfirmime të rëndësishme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Duhet të shfaqni më shumë forcë dhe kurajo, sidomos sa i takon jetës sentimentale. Do të jeni shumë konfuz, ndaj marrja e vendimeve në këtë moment mund të jetë me rrezik. Bëni kujdes me shpenzimet!



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo e premtë është e rëndësishme për të pushuar dhe për të rigjetur të gjithë energjinë e shpenzuar në vendin e punës. Merrni më shumë kohë për të menduar për veten dhe mirëqenien tuaj, pasi kjo ditë do ju gjejë të lodhur. Projektet në çift janë mjaft të favorshme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë këshillon që të përvishni mëngët për të çuar deri në fund disa detyra që ju janë besuar. Tregohuni më të kujdesshëm me shpenzimet dhe sa i takon investimeve të mëdha.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ka disa çështje të cilat domosdoshmërisht, do të duhet ti zgjidhni vetëm. Jeni shumë krenar dhe për këtë arsye shpesh hezitoni të kërkon ndihmën e personave që ju qëndrojnë pranë. Megjithatë në këtë moment afrohen përgjigje të mëdha dhe negociata të shkëlqyera.

Koha Koha	KËNGËTARJA JONË NGA FOTO	ASTRONOMI ITALIAN, GALILEI POPULL (turq.)	▼	MBRETI SHQIPTAR	LUMË NË NIGERI	STËRVITJE LUFTE (shq.)								
LYERJE ME EMAL	○													
DYSHIMI MATERJE PËR GJINJE ARTIFICIAL	○													
▶	○													
FIJE TË HOLLA PREJ METALI	○				ZERO AKTORJA AUSTRALIANE, KIDMAN									
HYJNËSHA E HAKMA- RRJES NË MIT. GREKE	○			N. V. SHKRIMTARI GJERMAN, TOMAS (shq.)										
SUEDIA	○	EMRI I DYTË I HOMERIT GYP I HOLLË PËR TË PIRË NJË LENG												
LUMË NË SIBIR	○		LIMAN NË IZRAEL I PLOTË, I PAKUFI- ZUAR			SHKODRA					E ACARUAR (mjek.) ELEMENT RADIOAKTIV (U)	▼	PERËNDI GREKE E RINISË (mit.)	BËN RIME
VEGËL MUZIKORE ME TASTIERË	○					FUTBOLLISTI KROAT, DAVOR AKTORI AMERIKAN, KUIN								
PERVJETOR I RËNDËSI- SHËM I NJË NGJARJEJE TË SHËNUAR	○										PARA E VOGËL PREJ ARI GJOKSI, SISA			
▶	○			DRITË (lat.)	ZGJATEM ASEKSUALE									
LLOJ VALLEZIMI QË KA PREJ- RDHUN NGA LATINISHTJA	○								OKSIGJEN	BASHKËPU- NTORE				
ITALIA	○	I LUGËT FUTBOLLISTI TURK, SHUKUR					AUTOMOBIL ME PAGESË	DHJETË (turq.) FELDSPAT I BARDHË (min.)						
Koha Koha	NJERËZOR E FISNIK LISTA E GJELLËVE									PASURI E PATUND- SHME (vjet.)				
AGJERIMI I BEKTASHI- NJËVE							ZË I THELLË FEMRE (shq.) ART (lat.)							
ENTONI KUIN			NIKEL MILJE JAPONEZE			PERANDOR MONGOL (1556-1605) PARA E VJETER PERSIANE								
SHEGË				ISHULL NË MESDHEUN PEREND. VOLT										
INSTITUCION I STUDIMEVE TË LARTA														

FJALËKRYQ KLASIK

1	2	3	■	4	5	6	7	8	9
10			11	■	12				
13				14	■	15			
16					17		■	■	
■	■	18						19	20
21	22			■	23				
24				25	■	26			
27						■	28		

HORIZONTALISHT:

1. Showmani ynë, Krasta; 4. Shkrimtare angleze, Sharlot; 10. Lajm, haber; 12. Dordolec që vihet në kopsht, në arë etj.; 13. Regjisori japonez, Kurosava; 15. E mbyta dikë, e vara; 16. Aparat për detektim; 18. Verbimi i plotë (mjek.); 21. Lloj loje e fatit; 23. Dru i lartë (shum.); 24. Mbi normë; 26. Ngjyrë lëkure (shq.); 27. Ishull grek në detin Jon; 28. Muaj i pestë.

VERTIKALISHT:

1. Akademik (shkurt.); 2. Pjesës (... pasur parasysh); 3. Imitues; 5. Riçard Gir; 6. Pezmatim i vezoreve (mjek.); 7. Bëhem si gur, shtang në vend; 8. Perëndia e rrufesë në mit. Nordike; 9. Xhez këngëtarja, Ficxherald; 11. Treformësh, me tri fytyra; 14. Liman në Izrael; 17. Copë mishi pa kocka; 19. Qenie mitike shqiptare; 20. Dhanore e përemrit vektor "Ai"; 21. Monedhë e Shqipërisë; 22. Aktorja japoneze, Joko; 25. Onomatopeja e lopës.

ZGJIDHET: G. EMALIM, DILEMA, SILKON, TELA, O. ATE, NV, S. OMIR, OB, AKA, A. PIANO, SHUKER, JUBILE, RUBI, VALS, NGJATEM, NEOLATINE, AKIRA, FURA, DETEKTOR, AMAUROZA, LOTO, LISAT, ENORM, TENI, KORFUZ.

NJË CIGARE, NJË FRANG!

Australia me duhanin më të shtrenjtë në botë

Nga një tjetër rritje të tatimit së duhanit prej 12.5 për qind, nga kjo e shtunë një pako me 20 cigare në Australi, do të kushtojë përafërsisht 27 dollarë australianë, që në kundërvlerë i bie rreth 19 franga zvicerane. Në vitin e ardhshëm dhe një vit më vonë, çmimi pritet të rritet edhe me një tjetër 12.5 për qind. Qëllimi është që njerëzit të heqin dorë nga pirja e duhanit. Sipas një vështrimi global të revistës "Economist", cigaret janë më të shtrenjta në Australi sesa kudo

tjetër në botë, shkruajnë mediat botërore. Sa për krahasim: Sipas shifrave të statistikave, një pako me 20 cigare në Zvicër kushton mesatarisht 8.5 franga. Për shkak të tatimit të duhanit, çmimet zvicerane janë ndër më të lartat në Europë. Politika australiane ndjek një rekomandim të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Sipas tyre, tatimet e duhanit janë "deri më tani mënyra më efektive për të parandaluar që duhanpirësit të heqin dorë dhe fëmijët t'i

mbajnë larg nga fillimi i pirjes së duhanit". Për shtetin, tatimet më të larta nënkuptojnë më shumë para. Vitin e kaluar, arka shtetërore e Australisë mori rreth 7.8 miliardë euro tatime mbi produktet e duhanit. Deri në vitin 2020 parashihen të jenë 10.6 miliardë. Përveç kësaj, duhanpirësit në Australi po pengohen edhe me mjete të tjera. Australia ishte vendi i parë në botë që prezantoi pako të cigareve me foto shokuese të sëmundjeve të ndryshme.




Pret veshët dhe hundën për t'u dukur si kafkë. E quan veten artist

Një djalë nga Kolumbia ka prerë hundën dhe veshët, si dhe ka bërë tatuazh të zi rreth syve që fytyra e tij të duket si kafkë. Kalaca Skull, emri i vërtetë i të cilit është Eric Yeiner Hincapie Ramirez, është një artist tatuazhesh që ka bërë procedura kirurgjike ekstreme në dy vitet e fundit, thjesht për faktin se i kishte shumë qejf kafkat kur ishte i vogël. 22-vjeçari nisi të bënte modifikime vetëm pas vdekjes së nënës, e cila nuk e lejonte kurrësi që ai të "mbulonte me art" fytyrën. "Për mua, kafka është si motër, pjesë e familjes. Ndiem shumë i lidhur me kafkat, prandaj vendosa që të bëja këto modifikime", thotë Kalaca Skull.



Syri bionik nuk është më fantashkencë



Krijohet prototipi i parë i një syri bionik i stampuar me teknologjinë 3D, sipas një studimi të përshkruar në revistën "Advanced Materials" nga një grup shkencëtarësh të Universitetit të Minesotës të drejtuar nga Michael McAlpine. Ky sy përbëhet nga një bashkësi receptorësh të shndritshëm të vendosur në një gjysmësferë dhe ky është një hap i parë për të afruar me realitetin një teknologji që deri tani mendohej se ishte fantashkencë. "Deri tani sytë bionikë janë menduar si diçka prej fantashkence, por sot jemi më pranë se kurrë", komenton McAlpine. Studiuesit filluan punën e tyre me një kupë gjysmësferike prej xhami, më pas vendosën

një bojë të përbërë nga grimca argjendi, që janë lënë të thahen në mënyrë uniforme. Më pas përdoren materiale me bazë polimeri gjysmëpërçues për të stampuar fotodiodat, pra receptorët që konvertojnë dritën në elektricitet. I gjithë procesi zgjati rreth një orë. Por gjëja më e jashtëzakonshme është arritja e një efikasiteti prej 25%, duke transformuar dritën në elektricitet me gjysmëpërçues krejtësisht të stampuar në 3D. Hapi tjetër tani do të jetë të krijohet një prototip me receptorë të ndritshëm më efikas, si dhe që të kryhet stampimi në një material të butë gjysmësferik, që të mund të implantohet në një sy të vërtetë.

Zbulohet vaji që zëvendëson Viagrën

Sipas një studimi të ri, vaji i ullirit është shumë i mirë se Viagra për të ndihmuar në performancën e meshkujve në dhomën e gjumit. Ekspertët zbuluan se vetëm 9 lugë gjelle vaj ulliri çdo javë do të shkurtojë mundësinë e impotencës së maskullit deri në 40%. Ai gjithashtu rrit nivelin e testosteronit, i cili është hormoni kryesor maskullor. Studiuesit e Universitetit të Athinës theksojnë se Viagra mund të punojë për një afat të shkurtër kohor, ndërsa vaji i ullirit do të zvogëlojë mosfunksionimin e ereksionit për një afat të gjatë. Kreu i studimit, Christina Chrysohoou u shpreh: "Burrat që konsumojnë shumë vaj ulliri e



shohin që rreziku i impotencës është zvogëluar deri në 40%, në moshë më të madhe". Ajo gjithashtu sugjeroi konsumimin e arrave, frutave, perimeve dhe fasuleve.

1267 - Rabini Moses Ben Nachman themeloi komunitetin hebre në Jerusalemin.

1511 - Hapet Koncili i Pizës.

1614 - Vincent Fettmich dëbon hebrejtë nga Frankfurti i Gjermanisë.

1715 - Vdes Mbreti Luigji XIV i Francës pas sundimit 72 vjeçar - sundimi më i gjatë i ndonjë monarku të madh evropian.

1752 - Kambana e Lirisë arrin në Filadelfi.

1914 - Shën Petersburgu ndryshon emrin në Petrograd.

1916 - Bullgaria i shpall luftë Rumanisë.

1928 - Shqipëria shpallet mbretëri me Mbretin Zogu I si mbret.

1939 - Zvicra shpall neutralitet.

1946 - Greqia voton për monarki.

1961 - Konferenca Parë e shteteve të painkuadruara u mbajt në Beograd.

1965 - Fillon lufta kufitare mes Indisë dhe Pakistanit.

1971 - Katari shpall pavarësinë nga Britania.

1972 - Egjipti dhe Libia formojnë federatë.

KALENDARI HISTORIK 1 SHTATOR

PSE PIRJA E UJIT TË FTOHTË ËSHTË E DËMSHME



Shumë njerëz e shoqërojnë mëngjesin me një filxhan kafe dhe një gotë ujë të ftohtë, mirëpo duket se duhet të bëni kujdes me këtë praktikë të përditshme. Ju sjellim më poshtë disa arsye pse uji i ftohtë mund të ketë ndikim negativ në shëndetin tuaj:

- Uji i ftohtë formon muskuj të tepërt në sistemin e frymëmarrjes, duke çuar në mbingarkesë dhe rrezik më të lartë të infeksioneve, si infeksioni i fytit.

- Uji i ftohtë ngushton enët e gjakut, e cila zvogëlon hidratimin.

- Pirja e ujit të ftohtë shkakton trupin të punojë fort për të tretur ushqimin pasi lëngjet e ftohta ngurtësojnë yndyrat në gjak.

BURRI DHE PSIKIATRI

I ankohet burri psikiatrit:

- Më ndihmo doktor, nuk mund ta shoh më me sy gruan time!

- Po e shoh se paskan përfunduar ditët e mira në lidhjen tuaj. Gjërat do të bëhen keq e më keq. Mendoj se do t'ju ndihmonte nëse shkoni në det.

- Jo bre doktor. E keqja është se ajo di not.



Kur debati është i humbur, shpifja është arma e të humburit.

(Sokrati)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS